



Mobiljet dhe estetika e banesës

EDUARD GUXHOLLI



EDUARD GUXHOLLI

29.02.2019

TIRANE
Maxim



MOBILIET
DHE ESTETIKA
E BANESËS

10 - 11 - 1984 (Kuvendi)



SHTËPIA BOTUESE ~3 NËNTORI~

Redaktor: VEFIK QERIMI

P A R A T H È N I E

«Kultura e jetesës — na mëson shoku Enver Hoxha — ka të bëjë me njeriun gjatë gjithë jetës së tij. Ajo ka të bëjë me mënyrën e të ushqyerit, të higjenës e të veshjes, me mjediset e banesës e të prodhimit»¹⁾.

Krijimi i kushteve për një jetesë të kulturuar është i lidhur ngushtë pra edhe me sigurimin e mobilieve të përshtatshme që t'i plotësojnë kërkesat funksionale dhe estetike.

Si ta mobilojmë sa më mirë shtëpinë tonë? Ç'olloje mobiliesh nevojiten në përshtatje me mjediset e banave tona? Si t'i vendosim e t'i mirëmbajmë mobiliet? Rreth këtyre çështjeve bëhet fjalë në këtë botim, ku jepen njohuri të nevojshme për projektimin dhe ndërtimin e mobilieve si dhe kritere estetiko-funksionale të mobilimit të shtëpisë të banimit.

Ky botim u shërben si familiarëve ashtu edhe arkitektëve dhe teknikëve që punojnë në fushën e projektimit e të ndërtimit të mobilieve për t'u përgjigjur nevojave në fushën e mobilimit sa më mirë të banave tona.

Libri është ndarë në 4 kapituj. Në të parin jepen njohuri të nevojshme për projektimin e mobilieve dhe kritere estetiko-funksionale të mobilimit të apartamenteve të banimit, raportet e mobilerisë dhe të arkitekturës, dukuritë thelbësore të mobilieve të kohës, skemat planimetrike bazë të apartamenteve të banimit,

1) Enver Hoxha. Raport në Kongresin e 8-të të PPSH, f 144, viti 1981.

mobilimi i tyre si dhe përmasimi i mobilieve në përshtatje me këto skema. Në kapitullin e dytë jepen disa projekte të thjeshta mobiliresh përmjet e ndryshme të apartamentit, kurse kapitujt e fundit bëjnë fjalë përmjet e materjaleve të ndryshme në ndërtimin e mobilieve dhe përmirësimi i atyre.

Projektet janë dhënë të plota, dhe me sqarimet e nevojshme, me qëllim që të kuptohen lehtë jo vetëm nga specialistët përkatës por edhe nga vetë shtëpiaket të cilët janë të interesuar përmjet mobilimin sa më mirë të banesës së tyre.

Redaksia



KAPITULLI I

KËRKESAT FUNKSIONALE DHE ESTETIKE TË MOBILIMIT TË BANESAVE

1. Mobiliet dhe arkitektura

Ecuria e stileve të mobiljeve, zhvillimi i tyre në kohë, duhen parë së bashku me ecurinë dhe zhvillimin e arkitekturës, sepse ato janë të lidhura ngushtë dhe kushtëzojnë njëra-tjetrën.

Mjediset e ndërtesave, veçanërisht ato të banimit dhe socialkulturore formojnë hapësirat në të cilat njeriu zhvillon aktivitetin e jetës së përditshme, kurse mobiliet e vendosura kanë përmjet qëllim që t'i shërbejnë këtij aktiviteti. Përveç përmjet arsyesh paraqitja e mjedisave varet në një shkallë shumë të ndjeshme nga mobilimi i tyre d.m.th. nga sasia, përmasat dhe vendosja e mobilieve në to. Nga ana tjeter trajtimi arkitekturor i brendësisë së ndërtesës duhet të përputhet me atë të projektimit të mobilieve.

Dihet se arkitektura egjiptiane, që e mori nismën nga ajo mesopotamo-babylonase, u bë burimi mbështetës i arkitekturës greke. Me të njëjtën ecuri edhe mobileria egjiptiane, paraardhëset e së cilës ishin përsëri ato mesopotamo-babylonase, ndikoi fuqimisht në të gjithë mobilierinë antike.

Realizmi, eleganca, komoditeti, thjeshtësia dhe finesa karakterizuan si arkitekturën ashtu edhe mobilerinë klasike greke dhe romake.

Që nga antikiteti deri në ditët tona ndryshimet që janë bërë vazhdimisht në stilin e arkitekturës kanë ushtruar ndikimin e tyre në stilin e mobilieve dhe në tekniken e mobilimit.

Lidhja midis arkitekturës dhe mobilierisë e gjeti shprehjen e saj më të plotë në shekullin tonë. Zbulimi i materialeve të reja inxhinierike, paralel me zhvillimin e shkencave të fizikës, kimisë etj., solli zhvillimin me ritme të shpejtë të ndërtimit dhe arkitekturës e së bashku me to lindjen e arkitekturës bashkëkohore. Hap pas hapi me të, me të njëjtat kërkesa e tipare u zhvilluan mobiliet bashkëkohore. Ç'karakteristika kanë ato?

Mobiliet e sotme duhet të janë funksionale, të thjeshta, të qëndrueshme, të lehta në përgatitje e t'i përgjigjen karakterit industrial të prodhimit, tipizimit dhe standardizimit të tyre. Ato duhet të janë kompakte, me përmasa jo të mëdha, të transportohen lehtë e po kështu të montohen e të emontohen, të zënë sa më pak sipërfaqe e të kryejnë një ose më shumë funksione.

Niveli estetik i tyre pasqyrohet në gjetjen e përpjësimeve e linjave të duhura, në pastërtinë e paraqites së teksturës së drunit, në kombinimin e drejtë të ngjyrave dhe harmonizimin e tyre me mijediset ku vendoset mobilia, në përdorimin e drejtë të materialeve të ndryshme, si xhamit, metalit, tekstileve etj.

Përhapje të gjërë në fushën e projektimit të mobilieve ka gjetur projektimi i tyre në ansamble; mobiliet për dhoma gjumi familjare e individuale, dhomat e pritjes, këndet e ngrënies e të punës etj. Projektimi i mobilieve në ansambël jo vetëm ka përparësinë e padis-
kutueshme të krijimit sipas një koncepti të vetëm arkitektonik, por krijon fushë të gjërë për tipizimin dhe standardizimin e llojeve të mobilieve, elementeve e nyjeve të tyre. Në këtë kuadër, projektimi i mobilieve në ansambël jep mundësi të gjera edhe për sigurimin e ndërshkëmbëshëmrisë së elementeve të tyre. Ai ekonomizon më mirë sipërsfaqen e vendosjes së mobilieve e mobilieve të veganta.

Dukuri tjetër në mobiliet bashkëkohore është përdomrimi gjithnjë e më shumë i tekstileve, xhamit, metalit, lëkurëve, plastikës etj. Kjo gjë ka ardhur jo vetëm pse druri është material mungesor, por edhe sepse materialet e mësipërme i përgjigjen më së miri kërkeseve funksionalo-estetike të mobilieve dhe karakterit industrial të prodhimit të tyre.

Ndërtimi i mobilieve duke përshtatur stilet e kaluarë, në formë origjinale ose pjesërisht të huazuara, me kushtet e prodhimit të sotëm industrial, paraqet një prirje të mobilierisë bashkëkohore, sigurisht jo thelbësore, por dhe jo të pandjeshme. Prodhimi dhe përfektionimi i makinave të ndryshme të punimit të drurit ka krijuar mundësi që format e lakuara, të tornuara, të elementeve të ndryshme të mobilieve të hershme të prodhohen në kushte industriale duke realizuar ansamble mobiliesh të stileve të kaluara. Mënyrë tjetër realizimi është prodhimi i elementeve karakteristike me materiale plastike dhe i ngjitjes së tyre në trupin e mobilies.

2. Skemat planimetrike të apartamenteve të banimit

Studimi i seksioneve tip të banesave, i përbërjes dhe i shtrirjes planimetrike të apartamenteve, i përmasseve në plan dhe lartësi të tyre si dhe i perspektivës së zhvillimit, janë elementet bazë për projektimin e mobilieve të ndërtesave të banimit.

Banesat sot ndërtohen me një ose me disa seksione. Çdo seksion formohet prej dy e më shumë apartamenteve, përgjithësisht me tri apartamente prej të cilave dallojmë: apartament me një dhomë të vetme e aneks gatimi; me një dhomë + një dhomë me aneks gatimi; me dy dhoma + një dhomë me aneks gatimi dhe më rrallë me tri dhoma + një dhomë me ankes gatimi. Nyjet higjieno-shëndetësore, paradhoma e herë-herë edhe




Fig. 1. Skemat funksionale të apartamenteve të banimit
1 — Paradhomë; 2 — dhomë ndenjeje; 3 — aneks gatimi
4 — banje; 5 — dhomë

depot e vogla janë të pranishme në të gjitha llojet e apartamenteve.

Në organizimin planimetrik të apartamentit, pavarësish nga përbërja, e tij, bie menjëherë në sy shpërndarja e mjediseve rrëth paradhoms së vetme, grupimi i nyjes higjieno-shëndetësore me aneksin e gatimit, fqinjësia pa ndarje e këtij të fundit me dhomën e ndenjes, dukuri këto që lehtësojnë zgjidhjen planimetrike të apartamenteve. Ky fakt ka rëndësi në projektimin e mobilieve, sepse krijon mundësinë e përcaktimit të tyre në përputhje me kërkesat funksionale të jetës së përditshme të njeriut.

Duke u bazuar në dukuritë e përbashkëta të zgjidhjeve të ndryshme planimetrike dhe sipërfaqeve kufitare të mjediseve të tyre, dallojmë skemat funksionale të apartamenteve të banimit që jepen në fig. 1 si më poshtë: apartamenti me një dhomë + një dhomë me aneks gatimi, apartamenti me dy dhoma + një dhomë me aneks gatimi, apartamenti me tri dhoma + një dhomë me aneks gatimi.

Sipërfaqet e tyre janë të përcaktuara me norma projektimi, të detyrueshme për tu zbatuar, ndërsa përmasat e dhëna janë ato më të përdorshmet, të dhëna në kufij orientues minimale e maksimale.

Natyrisht që hasen edhe zgjidhje të tjera planimetrike, si rastet e kalimit nga dhoma në dhomë, zgjidhje me depo në paradhomë, me numër më të madh miedisesh etj., por për shkak se janë të rralla dhe nuk kanë ndryshime thelbësore me skemat bazë, përfektiviteti i mobilitit të tyre, ato u nënshtrohen kritereve të trajtimit të këtyre skemave.

Ndërtesat e tiera të banimit me përdorim specifik si shtëpitë e studentëve, dhomat e spitaleve, të hoteleve etj. mobilohen në përputhje me veçoritë e tyre.

Në zgjidhjet planimetrike të apartamenteve duhet të dallohen sipërfaqet kufitare të mjediseve të tyre, përmasat në plan dhe lartësi dhe pozicionet reciproke të dyerive e dritareve. Këto të fundit kanë gjëresi 88 cm,

$$\begin{aligned}
 a &= 500 \div 400 \text{ cm} \\
 b &= 300 \div 400 \text{ cm} \\
 c &= 140 \div 170 \text{ cm} \\
 \xi &= 280 \div 340 \text{ cm} \\
 S &= 12 \div 15 \text{ m}^2 \\
 S_1 &= 5,5 \div 4 \text{ m}^2
 \end{aligned}$$






Fig. 2. Permasat dhe sipërfaqet kufitare të mjediseve të apartamentit

142 cm, 166 cm dhe lartësi 127 cm; ndërsa dyert kanë gjërësi 70 cm, 80 cm dhe 90 cm; lartësi 200 cm. Lartësia dyshemë-tavan është 260 cm.

Siq tregohet në këtë figurë, në dhomën e ndenjes me aneksin e gatimit, dallohen rastet e vendosjes së dritareve përballë derës (fig. 2a) me atë të vendosjes në faqen anësore të saj (fig. 2 b); jepen gjithashtu edhe dy rastet e mundshme të vendosjes së ballkoneve apo lozhave në to; në dhomën tjetër të apartamentit, gjithashtu dallohen të dy rastet e vendosjes së dritareve në lidhje me derën (fig. 2. c). Këto të dhëna shërbejnë edhe për dhomat e tjera.

Sipërfaqja e parahomës lëviz në kufijtë 5-9 m², ndërsa përmasat e saj në plan ndryshojnë shumë, në varësi të skemës kompozicionale.

Së fundi duhet theksuar se studimi i vëmendshëm i skemave planimetrike bazë të apartamentit të banimit, sipërfaqeve dhe përmasave kufitare të mjediseve të tyre, ka rëndësi të veçantë sepse lidhet drejtpërdrejt me tipizimin si bazë e konstruktimit dhe e prodhimit të mobilieve. Kjo shpjegohet me faktin se, duke u nisur nga skemat planimetrike bazë përcaktohet bashkësia e mobilieve të përdorshme në apartamentet e banimit gjë që shërben më tej për tipizimin e llojeve të mobilieve, detaleve e elementeve të tyre.

3. Grupimi i mobilieve sipas shërbimit të tyre

Duke u nisur nga funksionet kryesore që kryen njeriu gjatë aktivitetit të tij të përditshëm në shtëpi (puna mendore ose fizike, ushqimi, çlodhja, pritja e miqve, fjetja etj), nga skemat planimetrike bazë të apartamentit të banimit si dhe nga prirjet e zhvillimit të familjeve të sotme, mund të përcaktojmë bashkësinë e mobilieve të apartamentit të banimit. Sipas afersisë së mjediseve të apartamentit dhe aktivitetit të përdit-

shém qé zhvillohet me to, dallojmé 4 grupe mobillesh:

- mobilie pér dhomat e ndenjes, tē fjetjes, tē famijéve, tē miqve e tē studiove;
- mobilie pér anekset e gatimit;
- mobilie pér paradhomma, lozha, ballkone, terracs;
- mobilie pér fémijé.

Tē katér grupet sé bashku formojnē bashkésiné e mobilieve tē apartamentit.

Mobiliet stacionare qé shérbejnē pér ndarjen e njérir mjesdis nga tjetri, ato tē ndértuara nē harénsrat e krijuara nē mur etj. takohen rrallé dhe ndértohen nē vende ku lejon kompozimi planimetrik i apartamentit.

Né grupin e paré pérfishien bufe-vitrinat, bufet, dollapet, komodinat, divanet, divan shtretér, kolluket, karriget, ndenjéset e vogla, shtretér;

Né grupin e dytē pérfishien dollapet, tavolinat, ndenjéset e vogla.

Né grupin e treté bějnē pjesé varéset e rrobave, dollapet e komodinat pér qéllime tē ndryshme, shezlonget.

Né grupin e katért futen dollapet, tavolinat, krevalat dhe karriget.

Brenda qdo grupi mobillesh, tē ndara sipas qéllimit tē pérdomimit dallojmé:

a) Mobiliet pér dhomat, nē tē cilat pérfishien: bufe-vitrinat pér ruajtje qelqurinash, librash e sendesh tē tjera, buseté pér ruajtje tē ekspozuar tē qelqurinave e artikujve prej fajance, piževe etj; dollapet pér rroba dhe ndérresa, pér libra, pér ené, stacionare¹⁾ ose tē varur nē mur; komodina pér ruajtje librash e mjete pune, tualeti, pér vendosje televizorésh dhe pér qéllime tē tjeria tē ndryshme; tavolina pér ngrénje, shkrimi, tualeti, pér kende pritjeje dhe pér vendosje televizorésh; divane, divan shtretér, kolluket pér pushim, pér puné dhe pér fjetje; shtretér familjaré dhe individualé; karrige e ndenjéset.

njése tē vogla pér puné, pér pushim me ndenjése tē forté, gjysmē tē buté dhe tē buté.

b) mobiliet pér anekset e gatimit, nē tē cilat pérfishien dollapet pér ruajtjen e enéve dhe tē sendeve ushqimore, stacionare ose tē varura nē mur, nén piatalaréze, tē kombinuar me tavoliné pune; tavolina pune, ngrénje, palosése, tē varura nē mur; ndenjése tē vogla pér puné, kryesish ndenjése tē fortá.

c) mobiliet pér paradhommat, bujet, ballkonet, qé pérfishiené varése rrobash tē varura nē mur, tē thjeshta, tē kombinuara, stacionare pas faqeve tē murit dhe lëvizise; dollapet dhe komodina pér ruajtje këpuocish, pér ruajtje tē sendeve tē ndryshme tē ekonomisë shtëpiake, pér rroba, pér qéllime tē ndryshme; kolluket e ndenjése tē vogla — përgjithësish tē paloshme (shezlonget); pasqyra tē varura nē mur, tē kombinuara me varéset e rrobave.

d) mobiliet pér fémijé, nē tē cilat pérfishien dollape fémijesh pér rroba, libra, lodra, tē kombinuar, tavolina e krevate lëmijesh dhe tē miturish, karrige tē vogla me ndenjése tē fortá, tē buta dhe gjysmë tē buta.

Mobiliet e pérakerta nga qéllimi i pérdomimit, kombinohen me njéra-tjetré dhe formojnë këndet e ndryshme tē apartamentit. Té tilla jané: bufe-bibliotekat ose bibliotekat me tavolina pune tē shkëputura ose palosése, tē ndértuara nē trupin e saj dhe me karrigen me ndenjése tē buté, formojnë këndin e studimit; divanet, kolluket, tavolina e vogël e mesit formojnë këndin e pritjes etj.

Zgjedhja e mobilieve pér mobilimin e apartamentit duhet bérë sipas sasisë sé dhomave tē tij, pérberjes sé familjes qé banon nē tē, profesionit tē pjesëtarëve tē saj dhe faktorëve tē tjeré. Një zgjedhje e drejtë nē përshtatje me faktorét e përmendur më sipër ekonomizon shpenzimet pér blerjen e orendive shtëpiake, duke më-njanuar mobiliet e panevojshme dhe siguron shfrytëzim më tē mirë tē sipërijaqes sé apartamentit.

1) Eshte fjsla pér ata dollapet qé mund tē pérdomen edhe pér ndarjen e dy mjesdisve.

4. Rregulla të përgjithshme për mobilimin e apartamentit

Në mobilimin e apartamenteve të banimit merren parasysh sasia dhe sipërfaqet e dhomave, qëllimi i përdorimit dhe orientimi i tyre, përbërja e familjes, shijet vetjake të njerëzve. Për një mobilim komod dhe estetik duhen respektuar një sërë rregullash që burojnë nga aktiviteti i përditshëm i njeriut në familje dhe nga kërkesat estetike që i dikton jeta etiko-morale e kulturore e shoqërisë.

Në radhë të parë, qdo mjedis duhet mobiluar në mënyrë të tillë që në tërësi të shprehë brendinë e tij; dhoma e ndenjes duhet të krijojë ndjenjën e komoditetit dhe të ngrohtësisë; ajo e mysafirëve atë të mikpritjes, aneksi i gatimit atë të pastërtisë, dhoma e fjetjes ndjenjën e qetësisë e kështu me radhë.

Mjediset e apartamentit në tërësi dhe këndet e ndryshme brenda së njëjtës dhomë duhet të jenë të harmonizuara e të shprehin të njëjtën shije e mendim estetik.

Shpërndarja e këndeve të fjetjes, të pushimit, të studimit, të ngrënies, etj., në apartament duhet bërë duke shfrytëzuar sa më racionalisht sipërfaqen e tij, pa sjellë pengesa e vështirësi për qarkullimin e njerëzve.

Mobiliet e të njëjtit ansambël dhe ato ato të ansambleve brenda së njëjtës dhomë duhet të harmonizohen me njëra-tjetrën në teksturën e drurit dhe në ngjyrën e tij.

a) *Dhoma e ndenjes dhe aneksi i gatimit* Dhoma e ndenjes në tërësi duhet të shprehë ndjenjën e ngrohtësisë dhe të komoditetit. Këndi i ngrënies në të duhet vendosur në afersi të aneksit të gatimit. Përgjithësisht ky kënd shkrihet me atë të ndenjës, i cili kur ndërtohet i veçantë duhet vendosur në qoshet më të thella të dhomës dhe në afersi të bufë-vitrinës.

Anekxi i gatimit duhet të jetë higjienik dhe konfort. Vendosja e pajisjeve të ndryshme në të, pjatalarëses, sobës, frigoriferit etj. si dhe i dollapëve, tavolinave pa-

losëse e mobilieve të tjera duhet bërë në mënyrë të tillë që të sigurohen kushte sa më të përshtatshme pune e lëvizjeje për njeriun dhe shfrytëzim maksimal të sipërfaqes e të hapësirës së tij. Kështu p.sh. për vendosjen e dollapëve të ushqimeve dhe të enëve shfrytëzohet hapësira e krijuar nën pjatalarëse, kurse për varjen e dollapëve të vegjël në të, e gjithë sipërfaqja e murit.




Fig. 3. Dhoma e ndenjës dhe aneksi i gatimit:

- 1 — dollap nën pjatalarëse
- 2 — tavolinë pune e hapshme,
- 3 — dollap enësh, 4 — frigorifer,
- 5 — element ndarës dekorativofunksional;
- 6 — tavolinë ngrënie,
- 7 — bufë-vitrinë,
- 8 — kolltuk;
- 9 — divan,
- 10 — tavolinë mesi
- 11 — sobë.

Kalimet në aneks lehtësohen duke i vendosur mōbiliet dhe pajisjet në vijë të drejtë.

Nëse anekset kanë sipërfaqe të mjaftueshme, këndi i ngrënies është mirë të vendoset në to.

Për të ekonomizuar sipërfaqen, tavolinat është mirë të bëhen palosëse, ose të varura në mur.

Ndarja e anekseve të gatimit me dhomën e ndenjës mund të bëhet me elemente dekorativofunksionale druri ose të kombinuara me metal, xham etj., të cilat rrisin vlerat estetike të mjedisit, nuk pengojnë qarkullimin e ajrit të ngrohtë dhe sipas formës së ndërtimit mund të




Fig. 4. Dhoma e fjetjes familjare:

- 1 — shtrat familjar, 2 — kokë shtrati, 3 — dollap rrobash dhe ndërresash, 4 — dellap ndërresash dhe tuleti; 5 — krevat i vogël fëmijësh

përdoren për vendosjen në to të sendeve të ndryshme të përdorimit të përditshëm, të gjelbërimit etj. Elemente ndarëse thjesht dekorative nuk duhen përdorur.

b) *Dhoma e fjetjes familjare* Shtrati në dhomat e fjetjes familjare duhet vendosur në pozicion drejtkëndor me murin për të siguruar ajrosjen e tij. Tualeti duhet vendosur pranë dritares në mënyrë të tillë që drita natyrore të bjerë në fytyrën e njeriut. Krevati




Fig. 5. Mobilimi i studios:

- 1 — biblioteka; 2 — divan shtrati; 3 — tavolinë mesi; 4 — kënd studimi

j. fëmijës duhet të jetë pranë dhe paralel me atë familjar. Këndet e studimit, kur vendosen në këto dhoma, duhet të jenë afër dritates për të shfrytëzuar driten natyrore ndërsa librat vendosen në mbajtëse librash të varur në mur. Është e këshillueshme që në këtë mjedis të vendoset një varëse e vogël rrobash që të mund të përdoret për varjen e rrobave para gjumit.

c) *Mobilimi i studiove* Studiot vendosen në pjesën më të qetë të apartamentit. Tërësia e tyre formohet




Fig. 6. Dhoma e fëmijëve:

- 1 = kënd studimi; 2 = mbajtëse librash e varur në mur;
- 3 = kënd lejërash përfëmijë, 4 = dollap rrobash, 5 = shtrat

nga këndi i studimit, biblioteka dhe nga këndi i çlodhjes. I pari vendoset pranë dritates me dritë nga e majta e atij që punon, kurse ai i çlodhjes në qoshet më të thella të dhomës. Studioja është mjedisi më i përshtatshëm edhe për pritjen e miqve. Në varësi të përbërjes së familjes dhe madhësisë së apartamentit ajo mund të përdoret edhe si dhomë fjetjeje përfëmijët.

c) *Mobilimi i dhomës së fëmijëve* Shtretërit e fëmijëve, përfëmijëve sa më racionalisht sipërfaqen, mund të bëhen me kate ose të lëvizshëm. Gjithnjë përkëtë arsyen në këto dhoma mund të përdoren divan-shtretër, tavolina të përbashkëta shkrimi e tualeti, kuti për ndërresa të vendosura nën shtrat, dollapi pëtë varur në mur etj.

Këndi i studimit duhet të vendoset pranë dritates, ai i lodrave në qoshet e thella të dhomës.

Dhoma e fëmijëve mund të përdoret edhe përfëmijëve, zgjidhje e cila i përgjigjet më së miri apartamentit me tri dhoma e ankes gatimi.

Mobilimi i një apartamenti banimi me tri dhoma e aneks gatimi tregohet në fig. 7. Në këtë apartament, në dhomën e ndenjës, këndi i ngrënies është i shkrirë me atë të ndenjës, ndërsa dhoma e fëmijëve është parashikuar edhe përfëmijëve. Mobilimi i saj është bërë me divan-shtretër, ndërsa dollapi i rrobave është i përbashkët me bufe-vitrinë. Në dhomën e fjetjes është parashikuar kënd studimi.

5. Mobilimi dhe mjedisi rrethues i apartamentit

Mobilimi i apartamentit është vetëm njëra anë, sigurisht ndër më të rëndësishmet, në krijimin e një mjedisi komod e të kulturouar; por, kjo do të ishte e pamjaftueshme në rast se nuk do të shoqërohej me zgjidhjen e shumë problemeve të tjera, të cilat paraqiten në trajtimin e brendësive të apartamenteve të banimit




Fig. 7. Pamje e përgjithshme e mobilimit të një apartamenti me tri dhoma e aneks gatimi:

- 1 — dollap enësh nën pjatalarëse;
- 2 — tavolinë pune e varur në mur;
- 3 — dollap ushqimi;
- 4 — frigorifer;
- 5 — element ndarës dekorativo-funksional;
- 6 — tavolinë mesi;
- 7 — bufe vitrinë;
- 8 — divan,
- 9 — shtrat familjar,
- 10 — kokë shtrati;
- 11 — dollap rrobash;
- 12 — dollap ndërreshash;
- 13 — krevat fëmijësh;
- 14 — kënd studimi,
- 15 — dollap rrobash e bufe,
- 16 — varëse rrobash,
- 17 — tavolinë e vogël,
- 18 — sobë.

dhe që, së bashku me ato të ndërtesave shoqërore, formojnë objektin e arkitekturës së brendësive — një degë e specializuar e arkitekturës. Vlerat e një mobilieje apo ansambi mobiliesh dalin në pah me vendosjen e tyre në mjedis, prandaj brenda qëllimit të këtij libri, do të flitet shkurtimisht për disa nga këto probleme.

Organizimi i brendshëm i apartamentit, së pari, duhet bërë në bazë të disa kërkesave logjike: zona e ngrënies, për shembull, duhet të jetë afér aneksit të gatimit, ajo e çlodhjes sa më larg zonës së aktivitetit dhe qarkullimit etj. Orientimi i mjedisave të apartamentit, shkalla e ndriçimit natyror të tyre, këndpamja, numri i banorëve dhe profesionet e tyre, formojnë gjithashtu të dhëna që duhen patur parasysh në organizimin e apartamentit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet gjetjes së një ekuilibri midis vëllimit, funksionit dhe shkallës së okupimit të apartamentit, krijojmë një mjedis të tillë që të shprehë intimitet dhe ngrohtësi midis banorit e mjesdit rrethues.

a) *Trajtimi linear dhe vëllimor* Mobiliet, elementet dekorative e funksionale të një mjedisit, në tërsi shprehin një bashkësi linjash pingule dhe horizontale; vëllime vetjake që artikulohen në vëllimet e tjera.

Brenda të njëjtit mjedis duhet kërkuar unitet linjash dhe vëllimesh; linjat e drejta me linjat e drejta, format rrighthore me format rrighthore. Por nuk duhet rënë në monotonji dhe përsëritje; një veprim i tillë do të krijonte një mjedis të mërzitshëm. I duhet larguar përqendrimi të linjave pingule në një qoshe dhe atyre horizontale në tjetrën, vendosjes bri më bri të dy vëllimeve mobiliesh të njëjta. Një vendosje e tillë mund të bëhet vetëm duke i ndarë ato me një element në mes. Pikësynimi kryesor i përdorimit të linjave e vëllimeve është të sigurohet në mjedis një ritëm i gjallë dhe natyror, nëpërmjet kombinimit të linjave në lartësi dhe poshtë, nëpërmjet harmonizimit të vëllimeve.

Mobilia duhet të jetë në përpjesëtim me mjedisin.

Një tavolinë ngrënjeje me përmasa shumë të mëdha, do të mbyste krejt një dhomë dite me përmasa të zakonshme.

Hapësira ndërmjet ansambleve të ndryshme të mobilieve, të pushimit, ngrënies etj., duhet të jetë e tillë që të sigurojë ajrosjen e tyre, të lehtësojë qarkullimin dhe t'i ekilibrojë ato.

Ngjyra e vetë mobilies zbeh ose nxjerr më në pah vëllimin e saj. Kur është shumë e fortë, ajo afirmon peshën e mobilies; në tonacionin e përgjithshëm të mjedisit, ose kur është e zbehtë, lehtëson një vëllim duke e ndërfutur në ansambël.

Për lartësi bazë, në kombinimin e linjave e vëlli- meve, duhet mbajtur lartësia e ndenjëses dhe e shpi- nës së karriges përkatësisht 45 cm dhe 70-72 cm.

b) *Trajtimi sipërfaqësor* Muret, dyshemeja, tavani formojnë sipërfaqet mbi të cilat kompozohen të gjitha elementët përbërëse të mjedisit. Nëpërmjet materialeve dhe ngjyrave, ato duhet të shkrihen në dekorin e përgjithshëm të mjedisit, e njëkohësisht, të jenë të ekilibruara mirë midis tyre. Pa këtë të fundit, nuk mund të krijohet asnjëherë një mëdis i këndshëm.

Muret mund të «embëlsohen» me anë të ngjyrosjes së përshtatshme; me anë të trajtimit të veçantë të sipërfaqeve (patinime të ndryshme), veshjeve pjesore me dru me anë të ndricimit të lokalizuar të tyre. Kur, për ngjyrosjen e tyre përdoren vizatime të ndryshme, duhet mbajtur parasysh që linjat pingule krijojnë idenë e zmadhimit të lartësisë, ato horizontale atë të zgogëlimit të saj.

Dyshemeja dhe muret, mund të përdoren për të «zmadhuar» sipërfaqen, për ta copëzuar ose moduluar atë. Një dysheme e njëjtë, për nga tekstura dhe ngjyra e saj krijon lidhje midis dy ose më shumë mjediseve; dhe ky vazhdim i një mëdisi në tjeterin «e zmadhon» në pamje atë.

Një trajtim i diferençuar i dyshemesë së një mëdisi duke e mbuluar me qilima të pjesshëm, për shem-

bull, lejon diferencimin e dy zonave: e zonës së ngrënies me atë të pushimit etj. Një ndarje e tillë, që kufizon zonat, pa copëzuar mjedisin, as lëvizjen, shpreh një mëdis të lirshëm e të gjallë.

Një dysheme e errët është e preferueshme në mëdis; ajo shkrijhet me mobiliet, nxjerr në pah vlerat e tyre e sidomos ngjyrën. E kundërtat, një dysheme e celur, vë në pah mobiliet e errëta. Por, ky kontrast, nuk duhet të jetë shumë i fortë, sepse mobiliet do të dukeshin si të pavendosura në dysheme, sikur «notojnë» në hapësirë.

Duhen preferuar, për mbulim, qilimat e mëdhenj të cilët tregojnë përpjesëtime reale të mjedisit dhe një dysheme unike. Në përdorimin e qilimave të vegjël duhet nisur nga vendosja e tyre sipas zonave të mjedisit, ngrënies, çlodhjes etj. Në odo rast, duhet mënjanuar vendosja e qilimave të vegjël në qoshe, sepse në këtë mënyrë, ato zgogëlojnë dekorin e mjedisit.

c) *Materialet* Përbajtja e materialeve është një kriter bazë që duhet patur parasysh në përdorimin e tyre për një mëdis. Ato mund të jenë të ngrrohta (druri, tekstili, lëkure etj.) ose të ftohta (metali, plastike, xhami etj.); të ashpër ose të lëmuar, të shkëlqyer ose të errët, të vrazhdë ose të butë. Harmonizimi, nga kjo pilkëpamje, është kërkuesë e domosdoshme për përdorimin e tyre me dobi.

Si rregull bazë, në një mëdis, nuk duhen përdorur më shumë se tri materiale. Në zgjedhjen e tyre duhet patur parasysh që të krijohet kontrasti i nevojshëm. Kështu p.sh. në muret e ashpëra, përdoren perde tyli, mëndafshi ose tekstili të butë, në një ansambël mobilisë druri mund të vendoset një tavolinë me pllakë xhami, etj. Të kontrastuara, materialet afirmojnë më dukshëm specifikën e tyre, duke shtuar kështu, sipas rastit, intimitetin në dhomën e pritjes, qetësinë në atë të fjetjes etj. Kjo është mjaft e rëndësishme: në mobiliet e një dhoma gjumi nuk mund të përdoret, në masë, një material i ftohtë si metali apo xhami. Duhet

mëngjanuar përdorimi i materialeve artificiale: të plastikës si dru, të cimentos si imitacion guri etj. Këto materiale janë pa jetë, pa ndjenjë.

c) Ngjyrat Ngjyrat e një mjedisit dhe të apartamenti në térësi duhet të formojnë një ansambël harmonik.

Tri janë mënyrat e përdorimit të ngjyrave në ansambël:

— Muret, dyshemeja, tavani etj. sillen rrëth së bardhës. Mobiljet, elementet e tjera dekorativofunksionale gjithashtu. Vetëm ndryshimi i materialeve krijuon bukurinë e mjedisit që shtohet me anë të përdorimit të thekseve të forta tonike: për shembull tufa lulesh, ose objekte të tjera të vendosura mbi sipërfaqet e bardha, krijojnë efekte ngjyrash.

— Në mjedis përdoret përgjithësisht një ngjyrë. Harmonia krijuhet duke manovruar me nuancat e kësaj ngyre; për shembull, blu e zbehtë — blu e gjallë — blu deti, ngjyrë mëndafshi — bezhë-brun. Mund të shoqërohen edhe tonet e përafërtë: e verdhë — e kuqe — portokall, ose ato plotësuese: blu — e kuqe, e verdhë — vjolloë etj. Përdorimi i fundit duhet bërë me kujdes e aftësi, sepse ka rrezik të çojë në vulgaritet.

— Kur preferohet përdorimi i shumë ngjyrave duhet të gjenden ekullibri dhe përpjesëtimet e duhura në shpërdarjen e tyre në mjedis.

Pilkësëpari duhen përcaktuar ngjyrat mbizotëruese — asnjëherë më shumë se tri — të cilat duhen shoqëruar apo përsëritur nga elementet e tjera, perdet, tapiceria, qillimat etj.

Nuk duhen vendosur bri njëri-tjetrit dy tone të forta sepse anulojnë njëri-tjetrin.

Në të gjitha rastet, nuk duhet harruar, ndikimi i orientimit të dhomës në përdorimin e ngjyrave. Tonet e ftohta krijojnë ndjenjën e hapësirës, ato të ngrohta mugëtojnë mjediset e mbindrikuara, prandaj, në mjediset me shumë diell duhen përdorur tone të errëta, në jug tone të ftohta (të hirta, të gjelbëra etj), në veri tone të ngrohta (të kuqërrëmta, të verdha etj).

d) Ndriçimi artificial Në mjedis duhen mëngjanuar zonat e errëta si dhe kontrastet e forta, të lodhshme përsyrin. Ndriçimi, para së gjithash, duhet t'i përshtatet mjedisit dhe kohës kur ai përdoret: gjatë punës, në dhomën e ndënjes, ai duhet të jetë i njëtrajtshëm, por, kur në dhomën e fjetjes fëmija fle e ne dëshirojmë të lexojmë, ndriçimi duhet të jetë i dyanshëm; të mos shqetësojë fëmijën dhe të lejojë leximin.

Pra, zgjedhja e ndriçuesve dhe vendosja e tyre duhet bërë në përputhje me kërkeshat e mjedisit; përdorimi i tyre, i nisur vetëm nga kërkeshat dekorative, është i gabuar: një llambë e thjeshtë, me intensitet drite të mjaftueshme, e alternuar me një ndriçues lokal, të përdorshëm sipas rastit, është shumë më e dobishme se sa një llampadar luksoz, me drithë të orientuar drejt tavanit, të ndërtuar prej metali (çeliku, nikeli etj.) që krijojnë ftohtësi metalike shumë pak të këndshme. Ndriçuesit lokalë, të vendosur në mure, të varur në tavan apo në formë abazhuri, duhet të shpërndahen në apartament në mënyrë që t'i shërbejnë qëllimit për të cilin vendosen dhe të përshtaten me dekorin e përgjithshëm të apartamentit.

Si duhet të jetë ndriçuesi? Transparent apo opak, i bardhë apo i ngjyrosur? Gjatë zgjedhjes duhet patur parasysh:

— Ndriçuesi transparent, lehtësisht i ngjyrosur — qoftë natyror apo i veshur me letër bezhë, rozë, rozë në të bardhë etj. — jep një refleks të ngrohtë e intim.

— Ndriçuesi opak shpërndan një drithë gjysmë të drejtpërdrejtë; për të drejtar drithën që shikon drejt tavanit në dysheme, mbi të duhet vendosur një ekran.

Me një ton të dalluar ai shpërndan një drithë të ngrohtë. Argjendi, nikeli, çeliku kanë një ftohtësi metalike shumë më pak të këndshme. Materialet imitues, plastikat, fibrat etj. nuk duhen përdorur në ndriçuesit.

Burimet lokale të dritave mund të përdoren në mjedisë edhe për të krijuar drithë hije, për të nxjerrë në pah një vepër arti etj. Një ndriçues me intensitet të

dobët, i vendosur prapa një bloku gjelbërimi, krijon një kombinim të këndshëm refleksesh e dritë hijesh.

Emisionet televizive duhen ndjekur në errësirë të plotë apo ndriçim normal? Zgjedhja duhet bërë e tillë që të mënjanojë lodhjen e spektatorit. Më i përshtatshëm është një ndriçim i lehtë, i mjedisit i miaftueshëm për të ekuilibruar dritën e ekranit, e cila, me gjysmëhijet, bën një kontrast të lodhshëm.

dh) *Ku duhen ndjekur emisionet televizive?* Më e përshtatshme është që televizori të vendoset në dhomën e ndenjies. Si rregull, duhet mënjanuar vendosja e tij në këndin qendror të këtij mjedisit. Prania e televizorit nuk duhet t'i imponohet jetës së përditshme të familjarëve; këndi i televizorit duhet të jetë i pavarrur, i mënjanuar nga zonat e aktivitetit të përditshëm. Duhet mënjanuar rënia e dritës natyrore mbi ekran; kjo gjë vështirëson shikimin e emisioneve televizive gjatë ditës. Lartësia më e rekomandueshme për vendosjen e televizorit është 1 m.

e) *Si duhen oraganizuar bibliotekat?* Ky është gjithashtu një problem që lidhet me përbërjen e apartamenteve të banimit dhe kushtet klimaterike.

Eshtë folur më përvatra për mobilimin e studios në apartament dhe për bibliotekën, por del pyetja: ku duhet vendosur biblioteka, librat, këndi i studimit?

Biblioteka në shtëpi dhe këndi i studimit është vendimë i dashur ku banori jeton me shoqërinë e librave. Ky kënd, pra, duhet të vendoset në vendet më të qeta. Për të kriuar kushte të favorshme punë e leximi.

Një bibliotekë, si mobilje, paraqitet mjaft dekorative. Mundësitet e gjëra që kanë ato për traitim arkitektonik, veshjet e shumëloishme të librave, objektet e vogla të artit dhe skulpturat, të kombinuara me librat, krijojnë një dekor jetësor e të gjallë, një objekt të kompozuar me një finesë të hollë.

Tablotë, fotografitë, aparatet televizive, radiot etj. zë-

në vend në mënyrë të natyrshme pranë librave; ky është një shoqërim mjaft logjik.

Nuk duhen ngatërruar bibliotekat me bufe-vitrinat. Qelqurinat e ndryshme nuk kanë vend në të parat, sikundër dhe librat duhen përdorur mjaft të kufizuar në të dytat; studimi dhe pritja e miqve janë dy punë të ndryshme.

f) *Vendosja e sendeve dekorative në apartament*

Taflatë, sendet e artit, lulet etj., janë të pranishme në çdo apartament. Duhen mënjanuar veprat vulgare, imitacionet, prirjet dekorative të eksposimit të tyre. Disa vepra të vërteta arti, vazo lulesh etj., të zgjedhura me shije e, të harmonizuara me dekorin e përgjithshëm të mjedisit — kjo është zgjidhja më e drejtë. Eksposimi pa kriter, mania e tepruar në zgjedhjen dhe përdorimin e sendeve dekorative e artistike në apartament dëmton arkitekturën e banesës.

6. Përmirësimi i mobilieve

Në përshtatje me kushtet e banesave tona dhe me kërkkesat funksionale dhe estetike të mobiljeve, zgjidhen dhe përmasat e tyre. Natyrisht ky është problem për prodhuesit e mobilieve të cilët në planifikimin dhe prodhimin në seri duhet të mbajnë parasysh dhe kushtet e përgjithshme të banesave tona. Por ky është gjithashtu problem edhe për vetë familiarët që janë të interesuar të sigurojnë mobilie në përputhje me kushtet konkrete të banesës së tyre.

Përmasimi i drejtë siguron jo vetëm komoditetin e shfrytëzimit të tyre, por mënjanon edhe ndërtimin e mobilieve me përmasa më të mëdha duke i prerë rrugën harxhimit të tepërt të materialeve.

Përmasat funksionale bazë të mobilieve varen nga përmasat e trupit të njeriut në qëndrime të ndryshme: në këmbë, ulur, gjysmë të shtrirë dhe të shtrirë. Në qëndrimin e parë përfshihen qëndrimi i lirë ballor dhe




Fig. 8. Përmasat e trupit të njeriut në qëndrime të ndryshme, në mm.

anësor, ai për marrjen e sendeve në lartësi e gjysmëlartësi, për varjen e rrobave etj. Përmasat e trupit të njeriut në këto qëndrime shërbejnë për përmasimin e bufe bibliotekave, bufeve të ndryshme, dollapëve përuajtjen e rrobave, ndërresave, enëve etj., mbajtëseve të rrobave e mobilieve të tjera.

Në qëndrimin ulur dallojmë atë të lirë, qëndrimin për studim, për ngrënje, pushim etj., në bazë të cilave përmasojmë tavolinat, divanet, kolktukët, ndënjëset e vogla etj.

Shezlonget e llojeve të ndryshme përmasohen duke u nisur nga qëndrimi në pozicion gjysmë të shtrirë i trupit të njeriut.

Divanet, divan-shtretërit, shtretërit familjarë dhe ata individualë përmasohen duke u nisur nga përmasat e trupit të njeriut në pozicionin shtrirë për fjetje ose për pushim.

Në figurën 8 jepen përmasat në qëndrimet e trupit të njeriut në këmbë, ulur dhe shtrirë.

Lartësia e trupit të burrit për përmasim pranohet 1740 mm, ndërsa ajo e trupit të gruas merret 100-130 mm më pak.

Ndryshimet në përmasa të pozicioneve të trupit të njeriut brenda pozicioneve bazë në këmbë, ulur dhe shtrirë, p.sh. midis atij ulur për ngrënje dhe atij për pushim jepen hollësisht më poshtë në përmasimin e mobilieve.

Duke u nisur nga qëllimi i shërbimit dhe nga mënyra e shfrytëzimit, mobiliet për qëllime përmasimi i grupojmë:

- mobilie për vendosjen e enëve, rrobave dhe ndëresave,
- mobilie për ndenie,
- mobilie për pushim,
- mobilie për fjetje.

Mobiliet për fëmijë për shkak të specifikës që lidhet me zhvillimin e tyre fizik trajtohen veçanërisht.

a) Mobiliet për vendosjen e rrobave Në ndarjet për

vendosjen e rrrobave të gjata (pallto, pardesy etj.), lartësia e fundit të dollapit nga boshti i varëseve duhet të jetë jo më e vogël se 1400 mm; lartësia e po këtij boshti nga dyshemeja jo më e madhe se 1900 mm. Varëset duhet të vendosen jo më pak se 50 mm nga fajja e sipërme e dollapit për të lejuar futjen e dorës. Gjerësia e ndarjes duhet të jetë jo më e vogël se 550 mm. Në pjesën e poshtme zakonisht vendosen kuti për ruajtjen e ndërresave.

Ndarjet për vendosjen e xhaketave bëhen me të njëjtën gjerësi dhe lartësi nga dyshemeja, ndërsa lartësia vetjake e tyre duhet të jetë jo më e madhe se 900 mm.

Rrobat mund të vendosen paralel ose tërthor me fasadën e mobilies.




Fig. 9. Përmasat e mobilieve për vendosjen e rrrobave

b) *Kutitë për ruajtjen e ndërresave* Ndërresat në kuti mund të vendosen nga një deri në tre rreshta në drejtimin gjatësor dhe në një ose dy rreshta në drejtimin

tërthor. Përmasat në të dyja rastet tregohen në fig. 10.

Lartësia e kutive lëviz nga 100-200 mm; lartësia e tyre nga dyshemeja nuk duhet të jetë më e madhe se 1250 mm.

Sergjenet për ruajtjen e ndërresave nuk duhet të vendosen në lartësi më të vogël se 200 mm njëri nga tjetri dhe jo më lart se 1250 mm nga dyshemeja.




Fig. 10. Përmasat e kutive për ruajtjen e ndërresave

c) *Mbajtëset e rrrobave në korridor*. Lartësia e varëseve nga dyshemeja nuk duhet të jetë më e madhe se 1900 mm, ndërsa largësia midis tyre dhe fakes së si-




Fig. 11. Përmasat e mbajtëseve të rrobave në korridor

pëmne të mbajtëses duhet të jetë më e madhe se 50 mm për të lejuar futjen e dorës. Lartësia e sergjenit për vendosjen e kapelave duhet të jetë jo më pak se 150 mm; thellësia e mbajtëses së rrobave më e madhe se 240 mm. Gjerësia e saj për 3-4 persona lëviz nga 900-1000 mm me 8-10 varëse.

Pasqyrat e vendosura në mbajtëse, skajin e sipërme duhet ta kenë 1650-1750 mm lart nga dyshemeja e të jenë më të gjera se 350 mm; pasqyrat e gjata jo më pak se 1000 mm, kurse pasqyrat e vogla 400 mm.

Mbajtëset e rrobave duhen pajisur me kuti për ruajtjen e këpucëve dhe pjesë për vendosjen e çadrave. Të parat mund të ndërtohen me dy ose tre rreshta. Largësia midis boshteve të një rreshti merret 150 mm, lartësia midis tyre 90 mm, ndërsa largësia midis rreshtave 250 mm. Në faqen e prapme të kutive duhen lënë vrima ajrimi. Përmasat e çadrës tregohen në figurën 11. Pjesët konstruktive për vendosjen e çadrave duhen ndërtuar në mënyrë të tillë që të lejojnë varjen e lirë të tyre dhe të mënjanojnë kontaktin me rrobat e varura. Mund të përdoren edhe enë të vogla, të fshehura, për grumbullimin e ujit të çadrave të lagura.

Përhapje të gjerë po merr ndërtimi i mbajtëseve të rrobave të kombinuara me dollapë për ruajtjen e rrobave e sendeve të ndryshme të përdorimit shtëpiak.

ç) **Ndarjet për vendosjen e enëve.** Enët dhe ushqimet ruhen në sergjene ose në kuti. Thellësia dhe lartësia e të parëve lëvizin nga 300 - 400 mm. Përmasat më të vogla të kutive ku vihen thikat, lugët etj. janë lartësia 60 mm, gjerësia 230 mm, gjatësia 260 mm, ndërsa përmasat më të vogla të kutive për vendosjen e mbulesave të tavolinave, picetave etj. janë përkatësisht 100 mm, 250 mm dhe 260 mm.

Kutitë ndërtohen jo më lart se 1250 mm nga dyshemeja, ndërsa sergjenet jo më lart se 1800 mm. Dalja e pjesës së sipërme nga ajo e poshtmja te dollapët nuk duhet të jetë më e madhe se 250 mm.




Fig. 12. Përmasat e ndarjeve për vendosjen e enëve

d) Ndarjet për vendosjen e librave Për shkak të përmasave të shumëlojshme të librave është vështirë të përcaktohen me saktësi përmasat kufitare të sergjeneve e të ndarjeve për ruajtjen e tyre. Në vendosjen me një radhë të librave thellësia lëviz nga 160 - 250 mm, ndërsa në atë me dy radhë shkon deri në 310 mm. Lartësia për të dyja rastet merret 220 - 300 mm. Rreshti i dytë i librave, për t'u dalluar pa qenë nevoja e nxjerrjes së tyre, mund të vendoset më lart se i pari:

Për libra të formave të mëdha, lartësia e thellësia e tyre duhet të jenë 300 - 350 mm.

Lartësia e sergjenit dhe e tavolinës së shkrimit nga dyshemeja merren përkatësisht jo më shumë se 1800 mm dhe 760 mm. Për të shfrytëzuar sa më shumë hapësirën bibliotekat mund të ndërtohen deri në lartësinë e tavat. Librat në pjesën e sipërme, në këtë rast merren me ndihmën e shkallëve të lehta.




Fig. 13. Përmasat e ndarjeve për vendosjen e librave

dh) Karriget dhe kolktukët e punës Gjerësia e ndenjëses së karriges lëviz nga 380-440 mm, ndërsa thellësia e saj duhet të jetë më e madhe se 400 mm. Në pjesën fundore ndenjësja zvogëlohet simetrikisht në të dyja anët deri në 35 mm. Lartësia e ndenjëses dhe e fundit të shpinores nga dyshemeja merren përkatësisht 420-450 mm dhe 720-760 mm.

Ndenjësja pjerrësohet nga horizontalja 0-6°, praktikisht deri në 50 mm, ndërsa shpinorja dhe pingulja 10-18° (70-90 mm). Këndi midis tyre lëviz në kufijtë 93-110°, ndërsa këndi i formuar nga tangentja e hequr në pozicionin më të brendshëm të këmbës duhet të jetë 60°.

Lartësia vetjake e shpinores merret 250-350 mm ndërsa krahëzat vendosen në lartësi 200-260 mm nga ndenjësja.

Traversa lidhëse e këmbëve të përparme, kur parashikohet në konstruksionin e karriges, duhet të ven-




Fig. 14. Përmasat e karrigeve dhe të kolltukëve të punës.

doset në lartësi jo më të vogël se 300 mm prej dyshesës, me qëllim që të mos pengohet futja e këmbës nën karrige.

Thellësia për kolltukët e punës merret pak më e madhe se ajo e karrigeve, 400-460 mm.

Shpinëza dhe ndenjësja e kolltukëve, shpesh edhe e karrigeve, realizohen gjysmë të buta ose të buta; te karrigjet përdoren më tepër të forta.

Rëndësi të veçantë te karrigjet dhe kolltukët paraqet sigurimi i qëndrueshmërisë së tyre. Në fig. 14 b dhe c jepen dy qëndrime ndenjur të njeriut që rrezikojnë qëndrueshmërinë e karriges. Për të shmangur rrëzimin e njeriut në këto pozicione dhe për të rritur qëndrueshmë-




Fig. 15. Përmasat e kolltukëve

rinë e karriges, pjesa fundore e këmbëzës së saj si dhe shpinorja pjerrësohen paksa me drejtim jaشتë nga pingulja.

e) Kolltukët; Këndi i pjerrësisë së ndenjëses nga horizontalja dhe shpinores nga pingulja, te kolltukët duhet të jenë përkatësish 0-10° (maksimum 150 mm) dhe 15-30° (maksimum 350 mm). Lartësia e ndenjëses nga dyshemeja lëviz në kufijtë 300-400 mm, por, në raste të veçanta përmasat kufitare të kësaj lartësie mund të merren 250 mm dhe 430 mm. Lartësia e krahëve nga ndenjësja, si te karriget, merret 200-250 mm. Thellësia e ndenjëses 500-600 mm ndërsa gjerësia realizohet jo më pak se 480 mm. Përmasat e mësipërtme tregohen në figurën 15.




Fig. 16. Skema të kthimit të divanëve në shtretër me palosje dhe rrëshqitje

ë) Divanet dhe divan-shtretërit. Divanet dhe divan-shtretërit po ndërtohen e prodhohen gjithnjë e më shumë për ndenje dhe përfjetje, zgjidhje e cila siguron shfrytëzim më racional të tyre dhe të sipërfaqes së mjedisit ku ato vendosen. Në figurën 16 jepet skematikisht

kthimi i divaneve në shtretër me palosje dhe rrëshqitje, ndërsa në figurën 17 dhe tabelën 1 jepen përmasat e tyre.






Fig. 17. Përmasat e divaneve dhe të divan-shtretëve

Tabela 1

| Emërtimi i mobili | Lartësia h_1 në mm | Thellësia, në mm | Gjatësia në mm |
|-------------------|----------------------|------------------|----------------|
| Divan | 350-450 | 600-700 | 1800-1850 |
| Divan shtrat | 350-450 | 800-900 | 1800-1850 |
| Shtrat tek | 350-450 | 700-800-900 | 1850 |
| Shtrat dysh | 350-450 | 1400-1700 | 1850 |



a



b




Fig. 18. Përmasat e tavolinave

f) Tavolinat Për t'i përmasuar sa më drejt tavolinat në përputhje me pozicionet e trupit të njeriut dhe me përmasat përkatëse të tij në këto pozicione, i ndajmë në këto grupe: në tavolina për ngrënje dhe për punë fizike, në tavolina studimi dhe për vendosjen e televizorëve.

Përmasat e trupit të njeriut në qëndrimin ulur jepen në figurën 18 a.

Tavolinat e ndërtuara me lartësi më të vogël se 720 mm dhe më të madhe se 760 mm, sikundër tregohet në figurën 18 b nuk janë komode, sepse nuk sigurojnë qëndrim normal të trupit të njeriut në pozicionin ulur për punë.

Lartësia e tavolinave për ngrënje, për punë fizike dhe për studim merret 720-760 mm, ndërsa për vendosjen e televizorëve ndryshon nga 300-720 mm.

Përmasat në plan që kap trupi i njeriut në pozicionin ulur janë: për tavolinat e grupit të parë a = 300 mm, b = 500 mm; për tavolinat e grupit të dytë a = 400 mm, b = 750 mm.

Sipas përmasave të mësipërme gjerësia dhe gjatësia e tavolinave në të dyja rastet, me lejime të vogla merren përkatësisht 750-1100 mm dhe 710-1350 mm. Në tavolinat zgjatuase gjatësia shkon 1700-1950 mm.

Përmasat më të vogla të kutive për ruajtjen e letrave e mjeteve të punës në tavolinat e shkrimit merren: gjerësia 250 mm, thellësia 350 mm, lartësia 80 mm. Në qoftë se këto lloj tavolinash shoqërohen me dollapë të vegjël anësorë ose kuti, largësia midis tyre, për të lejuar futjen e këmbëve të njeriut, duhet të jetë jo më e vogël se 520 mm.

g) Mobiliet për fëmijë. Në përshtatje me zhvillimin trupor, mobiliet e fëmijëve duhen përmasuar për fëmijë të moshave 3-4 vjet dhe 5-7 vjet.

Lartësia H e tavolinave për fëmijët e grupit të parë pranohet 480 mm ndërsa për ata të grupit të dytë 550 mm.

Lartësia h, për të lejuar futjen e lirë të këmbëve





Fig. 19. Përmasat e tavolinave dhe të karrigeve për fëmijë




Fig. 20. Përmasat e shtretërve dhe të mobilieve për ruajtjen e fëmijëve gjatë ditës

nën tavolinë, përkatesisht sipas grupmoshave nuk duhet të jetë më e vogël se 410 mm dhe 418 mm.

Për fëmijët e moshave 3-4 vjet lartësia h_1 e ndënjëses së karriges merret 260 mm, lartësia e shpinores H 510 mm, thellësia e ndenjëses B 260 mm ndërsa gjëresia e saj lëviz nga 250-300 mm.

Për fëmijë të moshave 5-7 vjet, sipas së njëjtës rendetje përmasat janë: 310 mm, 600 mm, 290 mm, 300 mm.

Për të dy grupmoshat këndi i pjerrësimit të ndenjëses nga horizontalja «a» dhe i shpinores nga pingulja «b» pranohen përkatesisht $0-2^\circ$ dhe $7-9^\circ$.

Gjatësia e shtratit 1 për grupmoshën e parë merret 1200 mm, për atë 5-7 vjet 1400 mm; për fëmijë deri në 16 vjet gjatësia pranohet deri në 1600 mm. Gjerësia për të gjitha rastet merret jo më e vogël se 600 mm (fig. 20 a).

Mobiliet për ruajtjen e fëmijëve gjatë ditës duhet të ndërtohen të tilla që të mënjanojnë dëmtimet e mundshme të tyre. Për të mos lejuar futjen e kokës së fëmijës largësia midis traversave rrëthuese nuk duhet të jetë më e madhe se 100 mm, ndërsa fundi duhet të bëhet i plotë dhe i butë (fig. 20 b). Elementet duhet të jenë të rrumbullakosura, pa cepa, të plasura etj.

KAPITULLI II

PROJEKTE MOBILIESH

Nëpërmjet figurave, tabelave dhe shpjegimeve, më poshtë paraqiten projekte mobiliesh të ndryshme me përmasat përkatese si dhe mënyrat praktike të montimit të tyre, në përpunje me kërkasat estetike e funksionale dhe mundësítë e kushtet e banesave tona.




Fig. 21 Ndenjëse e vogël

Tabela 2

Përmasat e ndenjëses së vogël

| Nr. i elementit | Emërtimi i materialit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|-----------------|-----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjërësia | Trashësia |
| 1 | Jastëk gome | 1 | 560 | 360 | 50 |
| 2 | Ndenjëse kompensatoje | 1 | 560 | 330 | 5 |
| 3 | Këmbëza | 4 | 300 | 50 | 25 |
| 4 | Traversa anësore | 2 | 350 | 50 | 25 |
| 5 | Traversa ballore | 2 | 560 | 50 | 20 |




Fig. 22. Mbajtëse librash e varur në mur

Bashkimi i faqeve horizontale me ato pingule për formimin e sergjeneve bëhet me kunja ose me kanal të fshehur. Përmasat e elementeve tregohen në figurë. Fa-

qet horizontale janë $400 \times 250 \times 15$ mm ato pingule $500 \times 250 \times 15$ mm. Mbajtësja mund të rimesohet, lustrohet ose të bojatiset me një ngjyrë ose me ngjyra të ndryshme për shembull, qafet horizontale ndryshtë nga ato pingule.

Një zgjidhje tjetër e mbajtëses së librave me të njëjtat elemente, jepet në perspektivë në figurën 23.



Fig. 23. Variant tjetër i mbajtëses së librave




Fig. 24. Tavolinë ngrënjeje zgjatuase

Tabela 3

**Fermant e tavolinës se ngrënies
zagjaturëse**

| Numri i elementit | D | Fermant, në mm | | |
|-----------------------|----|----------------|---------|----------|
| | | Gjatësi | Gjerësi | Frashësi |
| Plastikë mbarështuese | 2 | 650 | 800 | 20 |
| Plastikë mbrojtëse | 3 | 400 | 800 | 20 |
| Rimete | 4 | 240 | 45/55 | 45/55 |
| Traversë ekuatoriale | 5 | 380 | 100 | 15 |
| Traversë ekuatoriale | 6 | 380 | 100 | 15 |
| Traversë ballore | 7 | 600 | 100 | 15 |
| Traversë mesi | 8 | 600 | 80 | 15 |
| Takë drejtuese | 9 | 80 | 55 | 20 |
| Rimete | 10 | 320 | 40/50 | 20 |
| Takë mbante | 11 | 30 | 25 | 20 |

Bashkojmë me thith e kanal këmbëzat (3) me traversat andore (4) dhe (5). Pjeset e formuarë i bashkojmë ne te mjetin mëyrë me traversat ballore (6). Në traversën e mesit (7) në vendet e shënuara mbarëshejmë me vidha taret drejtuese (8) që me thithë e vrime të fshetur bashkojmë traversën me skeletin e tavolinës. Takot mbajtëse (10) po me vidha i mbarëshejmë në traversat ballore (6) në largësi 700 mm nga njera-tjetra. Rrashqitë (9) bashkojen me vidha me plakat mbështetëse (1). Për të mos përdorur vidha të gjata, në to hapen me rreze kanale me diametër me të madh se ai i vithës pa e pështuar frashësinë e rrashqitës. Për zgjaturën e tavolinës plakat mbështetëse (1) i rrashqitës së shkallës që në faza të parë e formuar vendosim plakat mbështetëse (2) e cila fiksohet me kumja të lire të traversat ballore (6). Kur mylljet tavolina, ato fushë nga kat (10).




Fig. 23 Skema e montimit të tavolinës zgjaturëse 12 ngrënies




Fig. 26. Pamje nga sipër e tavolinës. Pamje e këmbëzës, faveve anësore dhe e rrëshqitësit.

Përmasat e ndenjëses së vogël

Tabela 4

| Numri i elementit | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|-------------------|----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjërësia | Trashësia |
| 1 | Ndenjësja | 1 | 450 | 350 | 15 |
| 2 | Këmbëza | 4 | 440 | 25 | 40/25 |
| 3 | Traversa anësore | 2 | 300 | 50 | 25 |
| 4 | Traversa ballore | 2 | 350 | 40 | 15 |
| 5 | Traversa llidhëse | 2 | 230 | 30 | 15 |






Fig. 27. Ndenjëse e vogël në aneksin e gatimit




Fig. 28. Tavolinë palosëse e varur në mur

Tabela 5

Përmasat e tavolinës palosëse të varur në mur

| Numri i elementit | Sasi | Përmasat në mm | | |
|-------------------|------|----------------|----------|----------|
| | | Gjatësia | Gjërësia | Trasheza |
| 1 | 1 | 600/500 | 350 | 20 |
| 2 | 1 | 900/500 | 130 | 20 |
| 3 | 1 | 228 | 110/50 | 5 |
| 4 | 2 | 50 | 30 | 5 |
| 5 | 2 | 50 | 30 | 5 |




Fig. 29 Montimi i tavolinës palosëse të varur dhe fiksimi në mur

Në mbajtësen e plakës mbështetëse (2) mbërthejmë me vidha fiksueset (4), duke kapur njëkohësisht mbështetësin metalik (3). Bashkojmë, me ndihmën e mençave, plakën mbështetëse (1) me mbajtësen e saj (2). Mbështetësi metalik (3) rrrotullohet rrreh aksit pingul deri në puthitjen me mbajtësen (2) duke lejuar kështru palosjen e faqes mbështetëse (1). Në këtë të fundit përfutjen e dhëmbit të mbështetësit metalik (3) hapet nga pochtë një vrimë e vogël. Tavolina palosëse patinohet dhe lyhet me bojë vaji. Gjatësia e saj mund të bëhet 600 mm ose 500 mm sipas dëshirës. Mund të vendoset pranë pjatalarëve.




Fig. 30. Dollap enësh me tavolinë pune

Përmasat e dollapit të enëve me tavolinë pune

| Numri i elementeve | Emertimi i elementit | Sasia | Përmasat në mm | | |
|--------------------|----------------------|-------|----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjërësia | Trashësia |
| 1 | Pllakë mbështetëse | 1 | 1000 | 615 | 20 |
| 2 | Faqe fundore | 1 | 960 | 595 | 20 |
| 3 | Faqe anësore | 2 | 730 | 580 | 20 |
| 4 | Faqe shpinore | 1 | 986 | 730 | 5 |
| 5 | Derë | 2 | 580 | 500 | 20 |
| 6 | Mbajtëse ballore | 2 | 980 | 100 | 10 |
| 7 | Mbajtëse anësore | 2 | 530 | 100 | 10 |
| 8 | Faqe anësore | 2 | 830 | 580 | 20 |
| 9 | Pllakë mbështetëse | 1 | 500 | 615 | 23 |
| 10 | Kuti | 1 | 460 | 600 | 150 |
| 11 | Kuti pllakë tavoline | 1 | 460 | 600 | 20 |
| 12 | Listela | 6 | 550 | 12 | 6 |
| 13 | Gjysmëdoreza | 6 | d=50 | mm | |

Dollapi ndërtohet në hapësirën nën pjatalarëse.

Prerja e pllakës mbështetëse (1) duhet bërë sipas përmasave të pjatalarës për të lejuar futjen e saj në hapësirën e dollapit. Kutitë në këtë pjesë, për shkak të pjatalarës nuk mund të ndërtohen, por bëhen fallco. Për të ruajtur vazhdimësinë e tyre edhe te tavolina e punës ato ndërtohen të plota. Dorezat formohen nga bashkimi i dy gjysmëdorezave të mbërthyera secila në pjesën që i përket. Sipas dëshirës, në pjesën e brendshme, dollapit mund t'i bëhen ndarje të ndryshme horizontale. Tavolina e punës është lënë e hapur në pjesën e poshtme me qëllim që aty të mund të vendoset ndenjëse e vogël, por kjo sipërfaqe mund të trajtohet e myllur me sergjene ose kuti.

Të anekset, në rastet e ndërtimit të dollapëve në të tria faqet e muraturës ka rëndësi shfrytëzimi i qoshe-




Fig. 31. Hollësi të dollapit të enëve me tavolinë pune




Fig. 32. Hollësi të dollapit të enëve me tavolinë punë

ve. Një mënyrë e shfrytëzimit të tyre tregohet në figurën 33.




Fig. 33. Variant dollapi për të shfrytëzuar qoshet e ankesit




Fig. 34. Dollapi i vogël i varur në mur

Përmasat e dollapit të vogël të varur në mur

| Numri i elementit | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|-------------------|---------------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjerësia | Trashësia |
| 1 | Faqja e sipërme e fundore | 2 | 1000 | 300 | 20 |
| 2 | Faqe ndarëse | 1 | 960 | 300 | 20 |
| 3 | Faqe anësore | 2 | 460 | 300 | 20 |
| 4 | Dyer | 2 | 500 | 345 | 20 |
| 5 | Faqe shpinore | 1 | 990 | 490 | 5 |
| 6 | Faqe ndarëse | 1 | 960 | 300 | 5 |
| 7 | Listela | 4 | 300 | 10 | 10 |
| 8 | Gjuhëza trekëndore | 8 | 60 | 60 | 5 |




Fig. 35 Montimi i dollapit të vogël të varur në mur

Pas fiksimit të faqes së sipërme e asaj fundore (1) me anësoret (3) mbërthehen me ndihmën e listelave ndarëset e mesit (2) dhe (6); mbërthehet me gozhdë faqja shpinore (5) e me ndihmën e menteshave vendosen dyert (4). Dollapi patinohet dhe lyhet me bojë vaji.

Përmasat e elementeve tregohen në fig. 36. Trashësia e tyre është 25 mm. Pllaka mbështetëse (1) ka përmasa $800 \times 400 \times 20$ mm. Traversat tërthore (3,) ato gjatësore (2) dhe këmbëzat (4) bashkohen midis tyre sipas nyjes A. Tavolina rimesohet lustrohet e bojatiset njëngjyrëshe ose me ngjyra të ndryshme.

Në këmbëzën (1) mbërthehen me vidha listelat (2) dhe traversat mbajtëse (4). Po me vidha mbërthehen forcueset trekëndore (5) te listelat (2) dhe këmbëza (1). Në skeletin e formuar mbërthejmë me vidha pllakën mbështetëse (3). Listelat (2) dhe këmbëza (1) sipas dë-

shirës mund të bëhen në anën e jashtme me sekcion të rrumbullakët. Pllakat mbështetëse mund të rimesohet. Vrimat e vidhave duhet të stukohen. (Fig. 37).




Fig. 36 Tavolinë e vogël mesi




Fig. 37 Mbajtëse tavllash duhani

Tabela 8

Përmasat e mbajtëses së tavllës së duhanit

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjerësia | Trashësia |
| 1 | Këmbëzë | 1 | 590 | 45 | 15 |
| 2 | Listela | 2 | 590 | 16 | 15 |
| 3 | Pllaka mbështetëse | 1 | 300 | 205 | 10 |
| 4 | Traversë mbajtëse | 4 | 100 | 45 | 15 |
| 5 | Forcuese trekëndore | 4 | 50 | 50 | 25 |




Fig. 38. Kollukë me tavolinë në mes

Tabela 9

Përmasat e kollukëve me tavolinë në mes

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | Sasi | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|----------------------|------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjëresia | Trashësia |
| 1 | Këmbëza | 4 | 370 | 50 | 30 |
| 2 | Traversë tërthore | 2 | 750 | 50 | 30 |
| 3 | Traversë ballore | 2 | 550 | 100 | 25 |
| 4 | Shpinore | 4 | 550 | 160 | 25 |
| 5 | Anësore | 4 | 630 | 100 | 25 |
| 6 | Anësoret e shpinës | 4 | 500 | 100/65 | 25 |
| 7 | Shpinore | 2 | 550 | 65 | 25 |
| 8 | Pilakë mbështetëse | 1 | 570 | 580 | 25 |
| 9 | Traversë tërthore | 2 | 1740 | 100 | 35 |
| 10 | Këmbëza | 2 | 320 | 50 | 25 |
| 11 | Traversë | 2 | 500 | 50 | 25 |




Fig. 39. Ndërtimi i kollukëve me tavolinë në mes




Fig. 40. Hollësi të bashkimit të elementeve

Bashkohen me thithë e vrimë të fshehur këmbëzat (1) me traversat (2) dhe, pjesët e formuara me të njëjtën mënyrë bashkohen me anën e traversave (9). Vendosen këmbëzat (10) dhe kolltukët bashkohen me vidha me skeletin e formuar. Pllaka mbështetëse mund të hiqet; në vendin e saj mund të vendoset një jastëk, duke krijuar kështu mundësi shfrytëzimi të kolltukëve




Fig. 41. Mbajtëse librash

Tabela 10

Përmasat e mbajtëses së librave

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjërësia | Trashësia |
| 1 | Faqe sergjeni | 8 | 900 | 260 | 25 |
| 2 | Faqe pingule | 4 | 280 | 140 | 15 |
| 3 | Faqe pingule | 4 | 280 | 140 | 15 |

Faqet pingule (2) dhe (3) montohen dy e nga dy mbi njëra-tjetrën me thithë e kanal të fshehur. Faqja e sergjenit (1) bashkohen me to me kanal sa trashësia saj (Hollësi B). Kjo e fundit për të mos u dukur bashkimi, nuk e përshkon faqen pingule (2) e cila duhet vendosur në pjesën e përparme. Faqet pingule (3) bashkohen me njëra-tjetrën në pjesën prapa me pllakë metalike. Ky bashkim përdoret edhe për varjen e tyre në mur. Mbajtësja e librave mund të ndërtohet edhe e vendosur drejtpërdrejt në dyshemë, duke i vendosur elementet njëri mbi tjetrin (fig. 43).




Fig. 42. Ndërtimi i mbajtëses së librave




Fig. 43. Mbajtëse librash e vendosur mbi dysheme




Fig. 44. Shtretër të lëvizshëm

Përmasat e shtretërve të lëvizshëm

Tabela 11

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | sasia | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|--------------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjerësia | Trashësia |
| 1 | Traversë anësore | 4 | 1900 | 250 | 25 |
| 2 | Traversë ballore | 4 | 1000 | 250 | 25 |
| 3 | Traversë mesi | 4 | 950 | 60 | 25 |
| 4 | Tako mbajtëse | 8 | 100 | 50 | 25 |
| 5 | Susta ose rripa llastiku | ml 42 | | | |
| 6 | Forcuese trekëndore | 8 | 100 | 100 | 25 |




Fig. 45. Mënyra e ndërtimit të shtretërve të lëvizshëm





Fig. 46. Shtretërit në pozicion të veçantë nga njëri-tjetri

Duke përashtuar ndërtimin e skeletit të këmbëzave me krahëzat, shtretërit e lëvizshëm ndërtohen njëloj si njëri mbi tjetrin pa pasur nevojë të hiqen dyshekët. Në këtë pozicion mund të përdoren edhe si divanë, duke trajtuar njërin me tapiceri. Si shpinëza përdoren jastekë të veçantë. Siç shihet ata ndërtohen lehtë dhe ekonomizojnë mjaft sipërfaqen e dhomës.



47. Kënd studimi

Tabela 12




Fig. 48. Skemë ndërtimi e këndit të studimit

Përmasat e këndit të studimit

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjerësia | Trashësia |
| 1 | Dyer rrëshqitëse | 2 | 500 | 360 | 20 |
| 2 | Faqe anësore | 2 | 400 | 350 | 20 |
| 3 | Faqe fundore | 1 | 1000 | 350 | 20 |
| 4 | Faqe e sipërme | 1 | 1000 | 350 | 20 |
| 5 | Faqe shpinore | 1 | 1030 | 400 | 5 |
| 6 | Plikë mbështetëse | 1 | 1040 | 350 | 20 |
| 7 | Këmbëzë metalike | 1 | 800 | Ø 16 | |
| 8 | Listela | 4 | 1000 | 5 | 5 |

Tabela 13

Përmasat e varëses së rrobave

| Numri i elementeve | Emërtimi i elementit | Sasia | Përmasat, në mm | | |
|--------------------|----------------------|-------|-----------------|----------|-----------|
| | | | Gjatësia | Gjerësia | Trashësia |
| 1 | Traversa pingule | 4 | 1850 | 50 | 20 |
| 2 | Traversa horizontale | 2 | 1250 | 50 | 20 |
| 3 | Faqe anësore | 2 | 300 | 330 | 20 |
| 4 | Faqe e sipërme | 1 | 1250 | 300 | 20 |
| 5 | Faqe fundore | 1 | 1250 | 300 | 20 |
| 6 | Dyer rrëshqitëse | 2 | 650 | 260 | 20 |
| 7 | Faqe shpinore | 1 | 1240 | 340 | 5 |
| 8 | Plikë horizontale | 1 | 200 | 50 | 10 |
| 9 | Plikë pingule | 1 | 200 | 30 | 10 |
| 10 | Damask. | 1 | 1650 | 850 | |
| 11 | Varëse metalike | 4 | | | |
| 12 | Pasqyrë | 1 | | | |
| 13 | Listela | 4 | 1200 | 5 | 5 |




Fig. 49. Varëse rrobash

Bashkimi i fajeve anësore (3) me fajen e sipërme (4) dhe atë fundore 5 bëhen sipas fig. 50. Fajja shpinore (7) në skeletin e formuar mbërthehet me gozhdë të vogla. Dyert rrëshqitëse (6) montohen me ndihmën e listelave (13). Traversat pingule (1), të vendosura në baraslargësi nga njëra-tjetra mbërthehen me vidha me ato horizontale (2). Mbërrthimi bëhet që nga këto të fundit. Më tej mbërthehet damasku në traversat horizontale (2); në atë të sipërmën sipas hollësisë «B», në të poshtmen sipas hollësisë «C». Mbërrthimi bëhet me gozhdë të vogla në çdo 50 mm larg njëra-tjetrës. Për të mënjanuar çarjen e damaskut, mbi të vendosim një rrip lëkure ose bezeje të trashë. Varëset metalike (11) mund të jenë të for-





Fig. 50 Ndërtimi i varëses së rrobave

mave të ndryshme. Mirë është që të jenë të nikeluara ose të kromuara. Ato mund të vendosen edhe në dy nivele, në formën e kutive të shaut. Varësja mund të

lustrohet ose tē lyhet me bojë vaji. Mund tē bēhen me tē njëjtën ngjyrë dyert e vogla (6) dhe traversat pin-gule (1) dhe me ngjyrë tjetër elementet e tjera. Ngjyrat duhet tē harmonizohen me ato tē damaskut. Në



fund fiksohet pasqyra (12) me vidha tē vogla e me kaph pëse tē lehta metalike «L».

Përmasat e elementeve pér tē dyja llojet e varëseve tē vogla tē paraqitura jepen në figurën 51. Në varësen lart elementet bashkohen me kunja metalikë; në atë poshtë me thithë tē rrumbullakët e vrimë tē fshehur. Përmasat mund tē ndryshohen sipas vendit ku ato do tē vendosen.




Fig. 52. Mbajtëse lulesh

Bashkimi i elementeve bëhet me gjysmë klapë. Plaka mbështetëse bëhet prej xhami duke u lyer me bojë tē zezë në faqen e poshtme. Përmasat mund tē bëhen sipas dëshirës.

Bashkimi i faqeve anësore tē kutisë së këpucëve me ato tē sipërme bëhet me kunja, ndërsa shkopinjtë pér mbajtjen e këpucëve me faqet anësore bashkohen me thith tē rrumbullakët e thith tē fshehur (Hollësi «A»). Në pjesën e përparme mbajtëses së këpucëve i vihet një perde e lehtë e varur në një fije metalike. Pér ajrim pjesa mbrapa lihet e hapur. Kutia mund tē përdoret me përmasat e dhëna në fig. 53 ose me përmasa tē tjera të zgjedhura sipas dëshirës.




Fig. 53 Kuti këpucësh

Këndi i lodrave për fëmijë

Këndi i lodrave për fëmijë duhet të jetë i prani-shëm në çdo apartament, sepse me të krijohet një bazë

e shëndoshë për edukimin e fëmijëve. Ai mund të vendoset në dhomën e fëmijëve ose në dhomën e ndenjes nëse apartamenti nuk e ka mundësinë për zgjidhjen e parë. Në ndërtimin e këndit duhet pasur mirë parasysh moshë e fëmijëve si në drejtim të përmasimit të elementeve ashtu edhe në përcaktimin e funksioneve që do të kryejë ai; do të jetë vetëm për lodra apo i kombinuar me mjete për studim e punë. Një kënd fëmijësh duhet të përbëhet nga kutitë, serjenet për mbajtjen e lodrave, revistave etj, tavolinës për punë, e studim, karrigeve për ndenje, shtresave të lehta për t'u shtruar në dysheme e që duhet të shërbejnë për të ruajtur fëmijën gjatë zvarrisjes e të krijojnë një sipërfaqe të pastër për vendosjen, rrëshqitjen apo rrökullisjen e lodrave të ndryshme, si dhe nga një sasi sa më e madhe lodrash, librash e revistash të zgjedhura në përshtatje me moshën e fëmijëve e kërkesat pedagogjike të tyre. Këto të fundit është mirë të mbahen në mbajtëse librash të varura në mur, në lartësi të shfrytëzueshme prej fëmijës.

Këndi i fëmijëve, atje ku lejojnë kushtet, duhet të jetë i lidhur me shtratin, dollapin e rrobave etj., me një fjalë të formojë një ansambël të plotë të ndenjës, fjetjes, lodrimit dhe studimit të fëmijëve. Nëse sipërfaqja e apartamentit nuk e krijon këtë mundësi, atëherë duhet synuar në ndërtimin e këndeve të çmontueshme për fëmijë. Këto formohen prej elementesh bazë, drusore apo plastike, të cilat montohen me njëri-tjetrin duke formuar mobiljet e ndryshme të këndit të fëmijëve: kuti për ruajtjen e lodrave, tavolina të vogla, mbajtëse librash etj. Pas përdorimit, mobiljet e krijuara çmontohen dhe elementet vendosen në vende të caktuara. Elementet duhet të tipizohen në mënyrë që, me sa më pak illoje prej tyre, të mund të krijojmë sa më tepër mobilie të këndit, të kenë peshë të lehtë e të jenë me zgjidhje të tillë montimi dhe çmontimi që vetë fë-

mijet tē mund t'i bējnē ato. Sipērfaqet e tyre duhet tē jenē tē pastra, pa tē çara, vrima, gozhdē etj. Mē poshtë paraqitet një kënd i tillë.

Kënd fëmijesh i çmontueshëm

Me këto lloje elementesh, kube druri me përmasa $50 \times 50 \times 50$ mm pllaka kompensateje ose dërrasa me përmasa 450×400 dhe 300×250 dhe kunja metalikë $\varnothing 10$ dhe $\varnothing 6$, me gjatësi 65 mm, mund tē ndërtohet një kënd i plotë lodrash pér fëmijë tē moshave prej 3 deri në 10 vjet.

Kubet e drurit (fig. 54) duhet tē jenë me faqe nē kënd tē drejtë dhe tē kenë pastërti tē mirë tē sipērfaeve pér tē siguruuar puthitje tē mirë me pllakat. Ato






Fig. 54. Kubet e drurit

vrimohen nē tē dyja faqet drejtkëndore, nē qendër tē tyre përkatësish me vrima $\varnothing 12$ dhe $\varnothing 8$.

Plakat formohen duke ngjitur mbi njëra tjetrën dy-tri fije kompensatë ose bëhen nē formë rame me trashësi 15 mm. Sipērfaqet e tyre duhet tē jenë gjithash tu tē lëmuara mirë, tē mos kenë tē çara, vrima, gozhdë etj. Në vijë tē drejtë, 25 mm larg brinjës së jashtëme, ato vrimohen me vrima $\varnothing 12$ rreth gjysma e sasisë dhe me vrima $\varnothing 8$ pjesa tjetër. Trashësia 15 mm është pranuar me qëllim që tē lehtësohet sa më shumë pesha e tyre (fig. 55 a).

Kunyat metalike janë me diametra $\varnothing 10$ dhe $\varnothing 6$ nē sasi tē barabarta. Në njerën anë ata kanë kokë 3 mm më tē dalë. Kunyat $\varnothing 10$ nē largësinë 250 mm nga maja vrimohen me vrimë me diametër $\varnothing 7$. Duhet tē jenë tē lëmuar e me skaje tē rrumbullakuara mirë pér tē shmangur gërvishjtjet e ndryshme gjatë përdorimit të tyre (fig. 55 b). Thelbi i montimit qëndron nē bashkimet e elementeve tē vendosura drejtkëndëshit me njëri tjetrin, me ndihmën e kubeve e kunjave metalikë.

Në ndërtimin e tavolinës si pllaka tē sipërmë vendosen ato që janë vrimuar me vrima $\varnothing 8$, ndërsa pllaka anësore vendosen ato që kanë vrima $\varnothing 12$. Edhe kubet vendosen nē mënyrë tē tillë që vrimat nē faqet e tyre tē përputhen sipas diametrave me ato tē pllakave; vrimat $\varnothing 12$ anash vrimat $\varnothing 8$ lart. Në faqet anësore, duke përshkuar ato dhe kubin, futen kunyat metalikë $\varnothing 10$ dhe pas tyre, futen nē faqet e sipërmë kunyat metalikë $\varnothing 6$. Këta tē fundit, duke përshkuar kubin, duhet tē kalojnë nëpërmjet vrimës së hapur nē kunjin metalik $\varnothing 10$. Prandaj gjatë këtij veprimi kjo e fundit rrotullohet derisa tē vijë vrima e saj nē pozicionin e duhur. Në këtë mënyrë kunyat metalike, duke u kapur me njëra-tjetrën, ajo anësore nuk lejon që tē bjerë faqja e sipërmë dhe anasjelltas ajo pingule që tē hapet faqja anësore. Pér ngjyrosjen e elementeve përdoren lloje tē shumta ngjyrash.



a)




Fig. 55. Pllakat dhe kunjat metallike




Fig. 56 Tavolinë e vogël






Fig. 55. Plakat dhe kunjat metallike




Fig. 56 Tavolinë e vogël






Fig. 57 Tavolinë me ndenjëse




Fig. 58 Mbajtëse librash e ndenjëse e vogël




Fig. 59 Dërrasë e zezë dhe kuti lodrash




Fig. 60 Kuti lodrash

Në figurën 61 paraqitet pamje perspektive e këndit të lodrave për fëmijë. Sipas dëshirës mund të krijohen edhe elemente të tjera për këtë kënd ose mund të ndërtohen në sasi të tjera, në varësi të sipërfaqes së apartamentit, fëmijëve, moshës së tyre etj.




Fig. 61 Pamje e këndit të lodrave për fëmijë

KAPITULLI III

PËRDORIME MATERJALESHPËR DRYSHME NE NDERTIMIN E MOBILJEVE

Në ndërtimin e mobiljeve përdoren gjerësisht materiale metalike, plastike, xhami, tekstilet e ndryshme dhe lëkurat dekorative, kashta etj, në përputhje me vëçoritë individuale të secilit; metali p.sh. përdoret në pjesët mbajtëse, sepse aty shprehet qëndrueshmëria e tij, tekstilet në pjesët e buta etj.

Bashkimet konstruktive të elementeve prej të njëjtë material ose prej materialesh të ndryshme kanë përqëllim të sigurojnë qëndrueshmërinë sa më të madhe të nyjes.

a) Përdorimi i metalit

Shembuj të ndryshëm të përdorimit të metalit jepen më poshtë.

Për të mënjanuar zhurmën që krijohet gjatë lëvizjes




Fig. 62. Seksione tërthore të elementeve metalike

së mobiles, fundi i këmbëzave metalike mund të bëhet me një shtresë gome të mbërthyer në takon e drurit, të futur me presim në këmbëz, (fig. 63 a), me tako dru-ri të dalshme (fig. 63. a, b) ose me kokëz plastike (fig. 63 c).




Fig. 63. Mënyra të ndërtimit të fundit të këmbëzave metalike

Bashkimet e elementeve metalike ndërmjet tyre mund të realizohen me saldim (fig. 64 a), me perçina ose me dado të vogla (fig. 64 b, fig. 65 a), me bulona e tub të filetar për bashkimet fundore (fig. 65 b), të çmon-




Fig. 64. Bashkime elementesh metalike

tueshme (fig. 65 c). Bashkimi gjatësor i tubave metalikë mund të bëhet me element të filetar (fig. 65 c), ndërsa llamarinat e holla e të profiluara me tubat metalikë mund të bashkohen me perçina ose të vendosen lirisht (fig. 65 d).




Fig. 65. Bashkime elementesh metalike




Fig. 66 Bashkim gjatësor i tubave metalikë me ndihmën e vidhave e vrimave të filetuara (a) me tub të vogël bashkues (b)




Fig. 67 Bashkim i krahëzave prej tekstile me tubin metalik me qepje.




Fig. 68 Bashkim i krahësave prej druri me këmbëzën metalle, me ndihmën e llamarinave të profiluara



Fig. 69 Bashkim i thjeshtë i drurit me metalin me vidhë




Fig. 70 Bashkim i drurit me tubin metalik: a) me vidhë e kunjë druri; b) me pllakë të salduar në tub dhe të bashkuar me vidhë me drurin




Fig. 71 Bashkim me pllakë metalle të fiksuar në dru me vidha dhe me qafore të filetar në tub; (a) me qafore shtrënguese të fiksuar me vidha në dru (b).

b) Përdorimi i xhamit

Xhami gjithashtu përdoret gjërësisht në ndërtimin e mobilieve. Ai mund të përdoret i kombinuar me dru, me metal, me plastikë etj., në vende të cilat nuk kanë kërkesa për qëndrueshmëri të lartë, në vende të dukshme, që duhet të mbrohen nga pluhurat etj.

Xhami mund të përdoret në gjendje natyrore ose mund të bojatiset në njérën faqe. Në rastin e dytë duhet mbajtur parasysh rregulli që xhami të bojatiset në faqen e prapme, sepse në këtë mënyrë ngjyra nëpërmjet xhamit duket me shkëlqim. Kështu bojatisen dyert rrëshqitëse prej xhami të bufe-vitrinave, bibliotekave etj. kurse serjenet prej xhami që ndodhen mbi nivelin e syrit të njeriut bojatisen në pjesën e sipërme; atë që ndodhen nën nivelin e syrit, në pjesën e poshtme etj.

Në ngjyrat e ndryshme që mund të përdoren rekomandohet ngjyra e zezë.

Me sukses, në ndërtimin e mobilieve mund të përdoren xhamet akulli ose të imituar.

Imitimi i xhamit akullit realizohet duke vendosur, të shtrirë plotësisht, në mes të dy pllakave të xhamit një fletë mushamaje të hollë të tejdukshme ose letër transparente. Në këtë mënyrë veprohet edhe për të përfituar imitimë të xhameve me ngjyrë, duke vendosur në mes të dy pllakave të xhamit mushama të hollë me ngjyrë ose letër me ngjyrë.





Fig. 72 Përdorimi i xhameve si dyer rrëshqitëse me hapje kanalesh në listelën e mbërthyer në trupin e mobilisë

Më poshtë jepen disa nga përdorimet e xhamit dhe hollësitë përkatëse konstruktive të bashkimit të tij me materialet e ndryshme në ndërtimin e mobilieve.




Hollësi 'A'




Hollësi 'A,,

Fig. 73 Si pllakë mbështetëse në tavolinat e vogla, xhami mund të mbështetet lirisht në skeletin e tavolinës ose mbi pjesë guarnicioni gome të mbërthyera në skeletin e tavolinës.



Hollësi 'A,,



Hollësi 'A,,

Fig. 74. Plakat e xhamit, të përdorura si sergjene, mund të mbështeten në kanalet e hapura në faqen e mobilisë ose mbi listelat e mbërthyera në to






Fig. 75. Mbështetja e pllakave të xhamit, në të njëjtin përdorim, mund të bëhet mbi profile «L» të vogla ose në llamarina të vogla, duke përdorur guarnicion gome




Hollësi 'B'

Fig. 76 Përdorimi i guarnicionit të gomës në rastet e mbështetjes së ndërmjetme të pllakave të xhamit, kur përdoren si pllaka mbështetëse tavolinash




Hollësi 'B'



Hollësi 'C'

Fig. 77 Përdorimi i xhamit në ndërtimin e vitrinave, akuariumeve të thjeshta etj. me anën e bashkimeve me llamarinë të profiluar, ku i duhet kushtuar kujdes vendosjes së guarnicionit të gomës dhe shtrëngimit me bulona.



Hollësi 'C'


(c) Përdorimi i tekstileve të ndryshme

Zanafilla e përdorimit të tekstileve në ndërtimin e mobilieve është mjaft e hershme. Tekstilet përdoren si material veshës dekorativ në mobiliet luksoze dhe në ato të thjeshta. Gjerësisht, tekstili është përdorur në veshjen e kolltukëve, kanapeve etj.


Për shkak të llojeve të shumta, vizatimit dhe ngjyrave nga më të ndryshmet, lehtësisë së përdorimit, qëndrueshmërisë relativisht të mirë, dhe rritjes së pandërrerë të prodhimit të tyre industrial, tekstilet sot jo vetëm po përdoren në masë, por në mjaft raste po zë-vendësojnë me sukses, deri edhe plotësisht, drurin. Kështu sot ndërtohen në masë mobilie të buta si divane, divan-shtretër, kolltukë etj. të veshur plotësisht me tekstil.

Në përdorimin e tekstileve duhet të kihet parasysh harmonizimi i ngjyrave dhe i vizatimit të tyre me karakterin e mobiliajve dhe të mjedisit ku do të vendoset mobilia.

Tekstilet mund të përdoren të kombinuara me druse metal. Mbërrthimi i tyre në lëndën drusore bëhet



Hollësi 'A'



Hollësi 'A'

Listelë shtrënguese

Stofë veshëse kompozitë

Fig. 78 Veshje e pjesshme e dyerve të dollapëve, bufeve etj. me tekstil

me gozhdë tē vogla me kokë tē gjerë pér tē mos e çarë atë; nē bashkimet me pjesët metalike përdoret qepja ose ngjitja e tekstilit.

Përdorime tē tekstilit dhe detalet përkatëse konstruktive tē realizimit tē bashkimeve jepen më poshtë.




Fig. 79 Veshje e plotë e dyerve me tekstil




Fig. 80 Mobilie tē buta tē veshura plotësisht me tekstil




Fig. 81 Veshje e faqeve ballore tē krevatit me tekstil. Mund tē përdoren dy fletë kompesatoje nē vend tē mbushjes me pambuk




Fig. 82 Përdorimi i tekstilit në mbajtësen e rrobave nē vend tē traversave tē drurit




Fig. 83 Karrige me skelet metalik me ndenjëse e shpinëzë tekstili. Fiksimi bëhet me qepje me qafore tekstili

c) Përdorime materialesh të tjera në ndërtimin e mobilieve

Lëkurat dekorative, thuprat e shelgut, kashtërat e ndryshme, materialet plastike etj. gjithashtu përdoren me sukses për ndërtimin e mobilieve.

Lëkurat dekorative përdoren në ndërtimin e mobilieve të buta, duke zëvendësuar plotësisht tekstilet. Ato janë të shumëllojshme, me ngjyra nga më të ndryshmet, me qëndrueshmëri të lartë, prandaj mobiliet e ndërtuara prej tyre kërkojen shumë; përdoren sidomos në ndërtimin e mobilieve që vendosen në ndërtesat social-kulturore, sepse kanë qëndrueshmëri të lartë dhe pastrohen lehti.

Thuprat e shelgut përdoren në ndërtimin e mobilieve me thurje si karrige, kolktukë, tavolina etj. Mobiliet e ndërtuara me to janë mjaft praktike, të lehta, të qëndrueshme prandaj përdoren shumë në mqedise të ndryshme pushimi.

Kashtërat dhe kallamat e llojeve të ndryshme gjithashtu përdoren në ndërtimin e ndenjëseve, shpinëzave të karrigeve etj.

Mobiliet e ndërtuara me materialet e përmendura më sipër, duke përjashtuar lëkurat dekorative takohen rrallë sepse ndërtimi i tyre bëhet kryesisht në formë artizanale.

KAPITULLI IV

MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE

Mirëmbajtja e mobilieve, në mënyrë që ato të jenë sa më jetëgjata, të ruajnë shkëlqimin dhe paraqitjen e duhur estetike kërkon që të njihen e të zbatohen disa masa:

Mirëmbajtja e mobilieve fillon që në paketimin e tyre në ndërmarrjet industriale. Paketimi i pjesëve të çmontuara të mobilies si dhe ai i mobilieve të plota duhet të jetë i tillë që të sigurojë plotësisht magazinimin dhe transportin pa dëmtim të tyre. Për këtë duhet që pjesët e mobilies, në gjendje të çmontuar, të fiksohen me njëra-tjetër në mënyrë që paketa e formuar të jetë e qëndrueshme; faqet e rimesuara e të lustruara duhet të vendosen me fytyrë nga njëra-tjetra, ndërsa si faqe të jashtme të paketës duhen vendosur ato të pëlustruara. Nuk lejohet mbështetja e drejtpërdrejtë e paketave në dysheme dhe kontakti i sipërfaqeve të ashpëra me ato të lustruara të pjesëve të mobilies. Sipas rastit si perde ndarëse ndërmjet elementëve përdoren copa të mëdha e të buta bezeje ose kartoni.

Mobiliet që paketohen të plota si karriget, tavolinat, mbajtëset e rrobave etj., gjithashtu duhen magazinuar me kujdes dhe transportuar duke marrë masa mbrojtëse për të mënjanuar dëmtimet e mundshme.

Mobiliet, që paketohen dhe transportohen të çmontueshme, pikësëpari duhet patur parasysh që gjatë montimit në shtëpi të vendosen mbi një bazament të nive-

Juar mirë. Lëvizjet nga niveli horizontal i këtij të fundit nuk lejojnë montim të mirë të pjesëve njëra me tjetrën, shkaktojnë mosmbyllje të mirë të dyerve, hapësira që dëmtojnë pamjen e mobilies dhe lejojnë futjen e pluhurave në to, humbjen e shpejtë të qëndrueshmërisë etj. Me kalimin e kohës, në mobiljet me dyer, mëtëshat fillojnë e dëmtohen dhe lind nevoja e zëvendësimit të tyre. Kur tavolinat, karriget, ndenjëset e vogla, divanet, kolitukët etj, qëndrojnë vazhdimisht në vende të paniveluara plotësisht, humbin qëndrueshmërinë.

Për mbrojtjen nga fërkimi me dyshemetë dhe për të mënjanuar zhurmat e krijuara gjatë lëvizjes, këmbëzat e mobilieve të përmendura më lart, vishen nga po-shtë me garnicion të hollë gome, i cili nuk duhet të duket në pamjen e jashtme të mobilies.

Mobiliet me lustër nuk duhet të vendosen në mjedise me lagështi, sepse u dëmtohet shtresa e lustrimit, ose në vende ku bien në kontakt të drejtpërdrejtë me rrrezet e diellit të cilat shkaktojnë zverdhjen e tyre.

Pas lustrimit në sipërfaqet e lustruara me guma-lilak fillon e shfaqet pluhuri i sheqerit të alkoolit, në të cilin ngjiten pluhurat e mjediasit që dëmtojnë shumë lustrimin dhe çojnë deri në heqjen e shkëlqimit të tij. Prandaj rekomandohet që gjatë gjashtë muajve të parë, pas lustrimit mobiliet me lustër të pastrohen çdo ditë nga pluhurat me shtupë garzash të thatë. Pas kësaj periudhe pastrimi duhet të bëhet jo më rrallë se një herë në javë.

Përgjithësia, me kalimin e kohës, shtresa e lustrës zverdhet ose humbet shkëlqimin. Pastrimi me shtupë garzash të butë është një masë e shtyn deri edhe në disa vjet rënien e shkëlqimit të shtresës së lustrës.

Shkëlqimi i sipërfaqeve të lustruara ruhet plotësisht duke i llakuar me furçë, me një ose me dy duar, me llak FF (fenoloid formaldehinë). Sipërfaqja para llakimit duhet të pastrohet mirë me shtupë të butë dhe, në qoftë se është e nevojshme, të rilustrohet. Llaku FF krijon një cipë mbrojtëse që e ruan shkëlqimin e shtre-

sës së lustrimit, por nuk lejon rilustrim të mobilies pa e trajtuar plotësisht me ksistër sipërfaqen e saj.

Rilustrimi i mobilieve duhet bërë pasi sipërfaqet që do të rilustrohen të janë pastruar mirë me garzë të bu-të, të njomur pak në tretje uji të pastër me sodë ose uji të oksigjenuar me amoniak, dhe të janë zumpuar pas tharjes me letër zumpare shumë të imët. Rilustrimi i sipërfaqeve të mobilieve bëhet njëlloj si lustrimi i parë i tyre.

Mobiliet e parimesuara, kur shtresa e lustrës së tyre është shumë e dëmtuar, rilustrohen pasi të jetë hequr më parë me ksistër shtresa e lustrimit. Mobiliet e ri-mesuara nuk mund të trajtohen me ksistër, sepse, për shkak të trashësisë së vogël të fletës së rimesos, gjatë trajtimit me ksistër kjo e fundit mund të dëmtohet.

Pjesët e dëmtuara të rimesos, ciflosjet e ndryshme etj. priten e hiqen dhe pjesa e sipërfaqes rimesohet përsëri me po atë lloj rimešoje. Kur ajo nuk mund të përdoret, atëherë përdorim rimeso të po atij druri e me teksturë të përafërt.

Tekstilet e mobilieve të buta mbrohen nga pluhurat dhe larjet e shpeshta duke i mbuluar. gjatë përdorimit të përditshëm, me tekstile të lehta, të qëndrueshme e më pak të kushtueshme.

Në rast se damasku i divaneve, kolitukëve, eti, hi-qet për t'u larë, ai duhet të rimbërthehet në skeletin e mobilies, pa u tharë plotësisht, sepse gjatë tharjes tku-rret dhe e zgoglon gjatësinë e tij.

Mobiliet e bojatisura me bojë vaji nuk duhet të janë pranë burimve të forta të nxehësisë, sepse për shkak të nxehësisë pajisjet e ndryshme të vendosura në to do të mbajnë vazhdimisht e vajit. Për të fituar shkëlqim të mirë sipërfaqet e këtyre lloj mobilieve mund të llakohen gjithashtu me llak FF.

PERMBAJTJA

Parathënie

3

KAPITULLI I

KERKESAT FUNKSIONALE DHE ESTETIKE TE MOBILIMIT TE BANESAVE

| | |
|--|----|
| 1. Mobiljet dhe arkitektura | 5 |
| 2. Skemat planimetrike të apartamenteve të banimit | 7 |
| 3. Grupimi i mobiljeve sipas shërbimit të tyre | 11 |
| 4. Rregulla të përgjithshme për mobilimin e apartamentit | 14 |
| 5. Mobilimi dhe mjeti rrethues i apartamentit | 19 |
| 6. Përmesimi i mobilive | 27 |

KAPITULLI II

PROJEKTE MOBILIESH

| | |
|--|----|
| — Ndjenjëse e vogël | 45 |
| — Mbajtëse librash e varur në mur | 46 |
| — Tavolinë ngrënë zgjatuese | 47 |
| — Ndënjenjëse e vogël në aneksin e gatimit | 51 |
| — Tavolinë palosëse e varur në mur | 51 |
| — Dollap enësh me tavolinë pune | 53 |
| — Dollap i vogël i varur në mur | 57 |
| — Tavolinë e vogël mesi | 60 |
| — Mbajtëse tavllash duhani | 61 |

| | |
|-------------------------------|----|
| — Kolitukë me tavolinë në mes | 62 |
| — Mbajtëse librash | 64 |
| — Shitetë të lëvizshëm | 67 |
| — Kënd studimi | 69 |
| — Varëse rröbash | 72 |
| — Varëse e vogël rröbash | 74 |
| — Mbajtëse lulesh | 75 |
| — Kutia këpucësh | 76 |
| — Këndi i lodrave për fëmijë | 76 |

KAPITULLI III

PËRDORIME MATERIALESH TË NDRYSHME NË NDËRTIMIN E MOBILIEVE

| | |
|---|----|
| — Përdorimi i metalit | 85 |
| — Përdorimi i xhamit | 90 |
| — Përdorimi i tekstileve të ndryshme | 93 |
| — Përdorime materialesh të tjera në ndërtimin e mobiljeve | 96 |

KAPITULLI IV

| | |
|-------------------------|----|
| MIREMBAJTJA E MOBILIEVE | 97 |
|-------------------------|----|



Guxholli, E.

Mobiliet dhe estetika e banesës.
[Red.: V. Qerimi]. T.; «8 Nëntori»,
1983,

104 f. me il.

(B.m.) : 729.9 +
+ 684.4
(B.v.) 729 +
+ 684.4
G. 18

lekë 7